



Drita e Kur'anit



at

FLETUSHKË E SHOQATËS SË NXËNËSVE TË MEDRESESE SË MESME "ALAUDDIN" NË PRISHTINË



Delibeg

Fjala e redaktorit



Në jetë kanë lindur shumë ideologji, rrymë e sisteme të ndryshme të cilat fillimisht, funksionojnë, zhvillohen, por ç'e do, kur ato perëndojnë! Shumë sisteme paraqiten dhe hyjnë në botën njerëzore, e robërojnë atë me doktrinat dogmato-sofistike, mësimi i tyre tenton të zhvillohet e ndriçojë më shumë por ç'e do, kur ajo është artificiale, e plogësht pa vlera të vërteta dhe domosdo duhet të dështojë. Koha ec e i zhvlerëson dhe imposht ato. Ky është një realitet i argumentuar. Pse kështu?! Vallë, a nuk ka diçka stabile-të përhershme? A nuk ka diçka që nuk perëndon?! A nuk ekziston diçka ku njeriu duhet të mbështetet dhe të gjejë pikëstrehimin e vet?!... Sigurisht se po. Është absurde të mos ekzistojë. Ekziston drita islame e mbrojtur, e lartë, e pazhvlerësuar, e cila me ndriçimin e saj Kur'anin ua humb vlerën të gjitha arealiteteve. Forca vepruese e tij asgjëson trillimet injorante...

Nën rrezet e kësaj drite hyjnore edhe ne nxënësit e medreses provojmë që pak a shumë ta reflektojmë Dritën e Kur'anit të masa e gjerë nëpërmes kësaj fletushke. Të vetëdijshëm për rolin pozitiv që mund të ketë "Drita e Kur'anit", dëshirojmë ta bëjmë sa më atraktive duke e sublimuar atë me gjëra interesante aktuale që janë në interes të përgjithshëm popullor. Veçanërisht jemi angazhuar që të japim kontributin tonë në sferën e edukimit fetar të rinia jonë e cila pritet të jetë pasuese e fjalës së Allahut xh.sh.

Le të shërbejë fletushka jonë si ushqim shpirtëror në zemrën e secilit person i cili anon kah e vërteta.

Dritën e Kur'anit reflektonë të të tjerët!

Besnik Berisha

Botues:

Shoqata e nxënësve të Medreses së Mesme
"ALAUDDIN" Prishtinë

Kryeredaktor:

Besnik Berisha

Këshilli redaktues:

Besnik Berisha, Enis Rama, Besnik Spahiu, Emin
Dërguti, Jakup Çunaku, Lulëzim Blaka, Irfan Kras-
niqi dhe Adnan Sogojeva.

Lektor dhe korrektor: Jusuf Gashi

Redaktor teknik: Nysret S. Simnica

Fleta del sipas mundësisë:

Adresa: Këshilli redaktues i "NUR'it" f.p. 89,
38000 Prishtinë, Tel. 038/32472 dhe 038/32-473.

Është lejuar botimi i fletës "NUR-UL-KUR'AN" me
vendimin e Sekretariatit për informata të Kuvendit të
Kosovës dhe Këshilli Ekzistues nr. 01-650-64 të
datës 18.03.1975 në Prishtinë.

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Përmbajtja:

Argumente të qarta mbi njësinë e Zotit.....	3
Njeriu, e vërteta për të.....	4
Rini e dini për çka jeni krijuar.....	5
Jeta e amshuar - Ahireti.....	6
Morali Islam.....	8
Fetva bashkëkohore.....	9
Kur'ani mrekullia e amshueshme.....	12
Syneri - tradita e Pejgamberit a.s.....	13
Vlera e shfrytëzimit të kohës.....	14
Disa statistika rreth Kur'anit.....	14
Shembulli i njeriut Jasinit në Xhennet.....	15
Përgojini.....	16
Devotshmëria e Xhurejxhit (hadith).....	18
Gusli, pastrim Islam.....	19
Namazi.....	20
Ju prezentojmë imamët tanë.....	23
Pirja e duhanit.....	24
Disa tregime nga historia Islame.....	25
Shkëndijëza Islame.....	26
Kuptimi i Zekatit.....	27
Satirë-humor-argëtim.....	28

ARGUMENTE TË QARTA MBI NJËSINË E ZOTIT

Historia njerëzore ende nuk ka arritur të zbulojë të ekzistuarit e së paku një fisi ose një populli e që pjesëtarët e tij të mos kenë adhuruar (besuar) në një ose shumë perëndi.

Pas hulumtimeve të bëra nga shkencëtarët e ditëve të sotme nëpër të gjitha viset e banuara të botës, duke filluar që nga ato fiset që ende nuk kanë arritur t'i kalojnë kufijtë e xhunglës e deri te popujt më të civilizuar, pjesëtarë të të cilit kanë arritur të shkojnë deri në Hënë, arrihet në përfundim se edhe sot vlen plotësisht një dukuri (fakt) i tillë.

Nga ajo që u tha më lart mund të konkuludojmë se feja dhe të besuarit në "fuqitë hyjnore" janë të vjetra sa edhe vetë njeriu apo thënë me fjalë tjera,, feja është thell e rrënjosur në natyrën e njerëzve.

Arsyetimi i një ideje të tillë (të besuarit në Perëndi), gjendet duke e analizuar pozitën e njeriut në oqeanin e madh kozmik të quajtur gjithësi.

Analizimi i njeriut dhe natyrës së tij nga kjo pikëpamje tregon se a nuk është i gjithfuqishëm.

Ai është krijesë e dobët e ndieshme dhe me fuqi (forcë) të kufizuar. Se sa gjëra të panumërta ekzistojnë që për njeriun janë të domosdoshme ose të nevojshme për mirëmbajtjen e jetës së tij, e që ai të mos i ketë në fuqinë e tij! Duke vërejtur malet, detin, retë, rrufen, vullkanet, trupat të ndryshëm qiellore, lëvizjet e tyre, harmonia në mes tyre e shumë dukuri të ndryshme të cilat ndodhen jashtë vullnetit dhe fuqisë së njeriut, atëherë, njeriu e vëren vetën se sa i pafuqishëm e i ndieshëm është ai. Prandaj nuk është çudi aspak që fenomene të tilla t'i fuqizojnë ndjenjat e lindura të njeriut për besimin në Zotin xh.sh.

Nga ajo që theksuam më lartë lirisht mund të përfundojmë se nevoja për njohjen e Perëndisë qenka thell e zhytur në shpirtin e njeriut ose nevojë më të cilën paska lindur njeriu. Duke jetuar në një injorancë totale, disa nga popujt e ndryshëm, me qëllim të plotësimit të kësaj nevoje filluan t'i adhurojnë sendet të cilat i rrethonin. Filluan të gdhendin gurë, drunj të ndryshëm që t'i ndërtojnë "hyjnitë" e tyre.

Disa të tjerë duke e vërejtur ndikimin e madh të trupave qiellor në planetin e tyre, filluan t'i çmojnë këto planete për "perëndi".

Por, të gjitha këto besime e religjione të ndryshme filluan të shkrihen dita ditës duke anuar vazhdimisht kah e vërteta,

kah zëri i arsyes e i logjikës, e ky është besimi në një Perëndi, i Cili assesi nuk mund të renditet në vargun e krijesave të Tij.

Të ndalemi dhe vetëm pak të shërbehemi me shkencat e astronomisë, kimisë etj.

Nga këto shkenca mësojmë se vetë karboni, oksigjeni si dhe të gjitha elementet e tjera janë produkt i një elementi të caktuar i cili është zier shumë në stufat kozmike, e ky është hidrogjeni (H_2). Me fjalë tjera hidrogjeni në brendësi të stufave yjore shndërrohet në helium, karbon, silicium, nikël, hekur e në elemente të tjera varësisht prej ndarjes dhe bashkëdyzimeve të tyre të sërishme në shkallët e caktuara të temperaturës dhe fuqisë së shtypjes. Thënë me fjalë të tjera, të gjitha llojet e krijesave rrjedhin prej materies unike, nga e cila është e ndërtuar gjithësia-ekzistenca, në format, detajet, figurat e saja të ndryshme etj.

Dallimi në mes të njërës dhe tjetrës krijesë, njerit lloj dhe tjetrit shprehet në raportin, marrëdhëniet ndërmjet kualitetit dhe kuantitetit, në përpjestime dhe të modeluarit e tyre, por lënda e parë është e njëjtë. Kjo është fshehtësia e cila na e zbulon ngjashmërinë ndërmjet njeriut dhe shtazëve, ndërmjet hundës që nuhat dhe lules aromatike, ndërmjet syrit dha pamjes së shkëlqyeshme të diellit duke perënduar. Këtu qëndron sekreti i kësaj harmonie dhe rregulli të gjithësisë. Çdo gjë që ekziston janë anëtarë të një familjeje, kanë rrjedhur prej një babai.

Uniteti i të krijuarës na jep unitetin e Krijuesit, por kjo nuk do të thotë janë çka edhe Autori i tyre.

Mund të themi se Allahu është i Gjithdijshtëm dhe Gjithpërfshirës, Ai është i cili i jep kushtet për jetesë secilës krijesë, Krijuesi i cili është mbi krijesat e veta, di çka ato nuk dinë, mundet çka ato nuk munden, sheh çka ato nuk shohin, Ai është një, i vetmi, Gjithëdëgjues, Gjithëpamës, i Gjithdijshtëm etj.

Përfundimisht mund të themi se çdokush le të vështrojë realisht natyrën e asgjë më shumë, e cila së shpejti do t'i japë shenjë në të vërtetën. Pa vështirësi një vështrim i tillë do ta orientojë njeriun kah Allahu.

JAKUP ÇUNAKU

KL. IIIb

NJERIU, E VËRTETA PËR TË

Njeriu është krijesa me e përsosur në tokë. Kur themi se është krijesë vetvetiu na bën të kuptojmë se e ka edhe krijuesin e vet. E Ai është Allahu xh.sh. i cili ka krijuar edhe krijesa të tjera para njeriut. Në Kur'an cekën fjalët e Zotit xh.sh. duke iu drejtuar engjëjve para se ta krijojë njeriun:

"Dhe kur iu tha Zoti yt melaikëve: Une po krijoj në tokë një zevëndës. Ata thanë: a do ta vendosësh në të (tokë) atë që bën çrregullime e derdh gjak, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tend dhe potësisht të adhurojmë! Ai tha: Unë DI ATË QË JU NUK E DINI!" 2:30.

Nga kjo rezulton se engjëjt e pritën me habi një vendim të tillë duke pasur parasysh natyrshmërinë e njeriut i cili është në gjendje të bëjë padrejtësi e zullum. Mirëpo, horizonti i njohurive të Allahut është i gjerë dhe i pakufishëm, prandaj Ai i di të gjitha specifikat të cilat e karakterizojnë njeriun e di p.sh. se në tokë përherë do të ketë edhe njerëz të cilët do të ndalen nga zullumi dhe veprat e shëmtuara e do të merren me progres, proporcionalisht me ligjin hyjnor ku thotë Allahu xh.sh.:

"Ne veç e kemi shënuar në Zebur, pas shënimit (ne levhi mahfudh) se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë" 2:105

Prandaj Zoti xh.sh. vendosi ta krijojë njeriun dhe vendimi i tij absolutisht duhet të realizohet.

Para se të krijohej njeriu, Allahu xh.sh. i pershtati atij të gjitha kushtet për një jetë normale; i krijoi qiejt, Diellin, Tokën, Hënën e shumë trupa të tjerë. Krijoi edhe ligje të shumta të cilat mundësuan jetën e njeriut. Toka sillt rreth boshut të vet, e së bashku me planetet tjera sillen rreth diellit e këto fenomene manifestojnë natën, ditën, temperaturën etj. Gjithashtu krijoi edhe mbështjellësin atmosferik tokësor i cili pengon sulmet e kometave dhe asteroideve të ndryshme të cilat kërcënohen njerëzisë, si dhe kryen edhe shumë funksione tjera me rëndësi. Pra Zoti xh.sh. krijoi edhe shumë fenomene tjera të cilat mund t'i numërojmë si parakushte për jetën e njeriut. Vështruar realisht mund të konkludojmë se njeriu i është siguruar një qetësi relative në tokë, e për të gjitha këto, çdo lavdatë i takon vetëm Allahut xh.sh.

Pasi t'i është përshtatur njeriut ambienti, atëherë vjen në konsiderim krijimi i tij. ai u krijua nga elementet e tokës duke kaluar në disa etapa derisa është formësuar në njeri. Këto procese i kryen melaiket me urdhërin e Allahut xh.sh. kurse shpirtin ia dha vetë Ai. Nga kjo kuptojmë se njeriu është genie e përbërë prej anës trupore dhe shpirtërore. Vetëm kur bashkohen këto dy elemente manifestohet jeta, kurse ndarja e shpirtit nga trupi shkakton vdekjen.

Për cilësinë dhe vlerën e qenies-njeri flet edhe vetë Allahu xh.sh.

"Veç e krijuam njeriun në formën më të bukur".

Zoti xh.sh. i ka dhënë njeriut shumë dhunti; se pari i krijoi parakushtet për jetë, e pastaj e krijoi njeriun të plotë e të dalluar prej të gjitha qenieve tjera tokësore. Atij i dha sytë që të shohë, i dha veshë që të dëgjojë, i dha gojë e hundë që të ushqehet e të marrë frymë i dha këmbë e duar që të ecë e veprojë, shumëllojshmëri e mbi të gjitha i dha mendjen-logjikën e cila e ngriti njeriun nga gjallesat tjera, ia mundësoi sundimin në tokë, i dha mundësi të planifikojë jetën e vet e shumëçka tjetër. Pra aftësitë për të gjykuar e arsyetuar e bëjnë jetën e njeriut të shenjtë-larg nga jeta shtazore.

Njerëzit e parë kanë qenë Ademi dhe Hava, e prej këtyre dyve u shumua njerëzia. Zoti xh.sh. në Kur'an thotë:

"O ju njerz, me të vërtetë ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre, ju kemi ndarë në popuj e fise që të njiheni, më i ndershmi prej jush është ai i cili është më i devotshmi".

Pra me shumimin e njerëzisë vjen edhe deri te formimi i popujve dhe i racave të ndryshme. Kështu që shfaqen edhe besimet të ndryshme, mirëpo pamarrë parasysh se ato besime a janë shfaqur në mënyrë pozitive apo negative, historia nuk mban mend të ketë ekzistuar ndonjë popull e të mos ketë besuar. Kjo është natyrshmëri e njeriut, pra pozitivisht apo negativisht, varet prej aftësive të njeriut se sa është në gjendje të bëjë seleksionime reale të dukurive.

Shikuar realisht pozitën më të mirë njeriut ia ka faktuar feja Islame. Athua mësimet e saj njeriun e stagnojnë apo përparojnë? dikush do të mendonte se Islami i ka ndaluar njeriut shumë gjëra dhe e ka kufizuar atë për të shfrytëzuar kënaqësitë e kësaj bote në mënyrë normale.

E vërteta është se Zoti xh.sh. i ka dhënë vendin meritë njeriut e ka udhëzuar në punë të mbara e ka ndaluar nga të këqijat, i dha prioritet nga gjallesat tjera duke i dhënë mendjen dhe arsyen. e vendosi në tokë si sundimtar e duke i plotësuar të gjitha kushtet për jetë, tokën e pajisi me cilësi produktive, kurse njeriun me cilësi intelektuale prandaj nga ai kërkohet që të jetë i kujdesshëm dhe kënaqësitë e kësaj bote t'i shfrytëzojë në mënyrë racionale.

Njeriu është i dalluar në shumë aspekte nga gjallesat tjera. Është i dalluar në krijim, përbërje, ardhmëri, etj., e shkaktar i këtyre dallimeve është vetë Allahu xh.sh. i cili i dha mundësi njeriut që të veprojë i lirë në këtë botë brenda mundësive të tij. Prandaj njeriu është një genie e vlefshme për vlerën e të cilit flasin shumë fakte siç janë: fizionomia e tij tejet e komplikuar, posedimi i shpirtit si fenomen i cili i tejkalon aftësitë e njeriut, sundimi në tokë e specifika tjera të shumta. Meqenëse njeriut i është dhënë dija, atëherë është plotësisht e arsyeshme që të shpërblehet në botën tjetër për veprat e mira ose të ndëshkohet për padrejtësitë e bëra ngase nuk ka qenë i detyruar të bëjë këtë apo atë, por vepra e tij është rezultat i vullnetit të tij të lirë.

Njeriu ka mundësi të jetë largpamës, vetëm atëherë kur ndalet dhe i shiqon gjërat esencialisht dhe me seriozitet. Është johumane që shenjat e Allahut në tokë, si dhe në vetveten tonë të mos i kushtojmë rëndësi dhe angazhim të veçantë. Të gjitha këto begati të Allahut janë mjaft të çmuara dhe të pazëvendësues, dhe se nuk ka padrejtësi e as mizori më të madhe sesa që të gjitha këto dhunti dhe potenciale që na i ka dhuruar Allahu xh.sh. t'u japim kahje negative e ta mohojmë qenien e përsosur-Allahun xh.sh.

Meqenëse njeriu është një krijesë e shenjtë, ngase Allahu e ka shenjtësuar atë, atëherë ai e ka, së paku, obligim moral që t'i përgjigjet ftesës së Allahut xh.sh., t'i përgjigjet ftesës së krijuesit të qiejve e tokës, Krijuesit të njeriut e të gjitha gjallesave tjera. Nënshtrimi i njeriut një genie mbinatyrore nuk e ul karakterin e tij njerëzor, por, përkundrazi, një nënshtrim i tillë është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm ngase vetëm të përlurur dhe duke respektuar urdhërat e Krijuesit të njeriut dhe begatit të shumta mund ta arrijmë qëllimin final, e vet arritja e qëllimit final flet mjaft për vlerën, rëndësinë, karakterin dhe për qenien njeri në përgjithësi.

Besnik Berisha kl. IV.a.

RINI, A E DINI PËR ÇKA JENI KRIJUAR?!

Rini islame !

Lavdërimi dhe falënderimi i takon Allahut xh.sh., përveç të cilit askush tjetër nuk meriton adhurim. Lus Allahun xh.sh., që të mëshirojë Muhamedin a.s., dhe njëkohësisht i dëshiroj përshëndetje, i cili është i pari muxhabid. Njëherit përshëndes familjen e tij, as-habët (shokët e tij të ndershëm) dhe të gjithë ata të cilët pasojnë rrugën e Kur'anit a.sh., dhe sunnetin burimor të Pejgamberit a.s., deri në Ditën e Gjy-kimit.

Rini, duhet të dimë se për çka jemi krijuar dhe çfarë janë obligimet tona? Jemi krijuar që të vërtetojmë qëllimin përse i bëjmë ibadet Allahut, nënshkrimin ndaj Madhërisë së Tij, përkuljes ndaj Tij dhe respektimin e dispozitave të Allahut xh.sh., dhe të Dërguarit të Tij, paqë dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të. E për këtë Allahu xh.sh., thotë në librin e Tij fisnik:

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë" (Edh-dharijat:56).

Jemi krijuar që t'i përmbahemi ligjit të Allahut xh.sh., të cilit nuk i mveshet e pavërteta nga asnjë anë në të cilën nuk ka dyshim sepse nuk është prodhim i mendjes së njeriut por është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit. Allahut xh.sh., vazhdon e thotë:

"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurresezi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpruarit" (Ali Imran:85).

Jemi krijuar të besojmë dhe ta nderojmë Allahun, pejgamberin dhe besimtarët në përgjithësi. Kur'ani fisnik na paralajmëron:

"Mbrotësi juaj është Allahu dhe pejgamberi i Tij dhe besimtarët të cilët me përulje kryejnë faljen (namazin), japin zekatin dhe janë të përvulur. Kush e merr për mbrotës Allahun, pejgamberin e Tij dhe besimtarët ta dinë se ata që janë me Allahun janë ngadhënjimtarë". (Maide:55-56).

Përgjegjësia jonë më e madhe me të cilën na obligoi (na bëri farz) Allahu xh.sh., është që ta realizojmë ligjin e Allahut në sipërfaqen e tokës, dhe largimi i njerëzve prej adhurnimit të krijesave (shirkut), largimi prej padrejtësive të sistemeve tjera dhe të drejtuarit kah islami, që është fe e ardhmërisë.

A e dini rini me çka realizohet ky qëllim?

Ky qëllim realizohet me anë të pesë cilësive që secili besimtar duhet t'i përforcojë në vetvete.

1. Me besim të thellë dhe paluhatshmëri: thotë Allahu xh.sh.:

"Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut të dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hirë të Allahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetë" (El-Huxhurat:15).

2. Me sinqeritet i cili nuk pranon dyfytirshinë (munafikllëk).

"E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin se ajo është feja e drejtë" (El-Bejjine:5).

3. Me këmbëngulje, trimëri e cila nuk pranon frikë, veç se të jetë frika ndaj Zotit xh.sh., thotë Allahut xh.sh.:

"Ata të cilët i kumtojnë shpalljet e Allahut i frikësohen vetë Allahut e askujt tjetër pos Tij" (El-ahzab:39).

4. Me punë e cila nuk ndjen lodhje e as mërzi.

"Dhe thuaj: veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të kthehemi te njohësi i të ishehtës dhe të dukshmës, e do t'iu njoftojë për atë që vepruat" (El-Tevbe:105).

5. Me sakrifikim dhe flijim të jetës nuk pranon agjë përpos fitores apo rënies shehid (dëshmor).

"Po ju menduat se do të hyni në xhennet pa u provuar edhe ju me shembullin e tyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur sa që i dërguari thoshte e me të cilët ata që kishin besuar, kur do të jetë ndihma e Allahut?!" *Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e Allahut është afër"* (El-Bekare:214).

Me të vërtetë këto janë cilësi të atyre që zbatojnë premtimin e dhënë Allahut xh.sh. Këto cilësi duhet të gjenden te rinia dhe janë veçori e të rinjve besimtarë. Prej kësaj nënkuptojmë se, rinia në të kaluarën dhe në çdo kohë kanë qenë dhe janë faktorë i përparimit apo rënies së popullit, bartës të flamurit - LA ILAHE IL-LALL-LLAH, dhe ata të cilët radhitën në rreshtat e para në front etj. Lidhje me këtë Allahut xh.sh., thotë:

"Ne po të rrëfejmë saktë çështjen e tyre. Ata ishin disa djelmosha që kishin besuar Zotin e tyre, e ne atyre edhe më ua shtuam bindjen" (El-Kehf:13). Duhet të dimë edhe këtë se grupi i parë i besimtarëve ishte rinia. Disa prej tyre kanë qenë: Ebu Bekri, Othmani, Omeri, Aliu, Abdull-Ilah bin Mesudi, Ammar bin Jasir etj.

Këta të rinj ishin ata që bartën mbi supet e tyre dërguesin (thirrjen) në islam. Këta janë të cilët kanë qenë të ndëshkuar për hirë të islamit.

Vlen të përmendim fjalën e Ukbe bin Nafi i cili u ndal në brigjet perëndimore të Oqeanit Atlantik dhe kur kaloi i tij shkeli afër detit tha: "O Zot, sikur të mos ishte deti do ta çliroja botën për hirë të ngritjes së fjalës - LA ILAHE IL-LALL-LLAH, O Zot, pra dëshmo!!". Dhe në fund dua që t'i bëjë apel gjithë rinisë islame ku gjindet prej lindjes e deri në perëndim sepse padyshim shoqëria jonë është e sëmurë, popullin tanë e kanë kapluar epshet dhe është e nevojshme që dikush ta udhëzojë këtë shoqëri, që të afrohet tek anija e shpëtimit. Duhet të jemi shembull në ibadet, në marrëdhënie ndërnjerëzore, në moral, në durim dhe në aktivitet, xhihad etj.

Duhet ta kujtojmë thënien e Omerit r.a., kur i drejtohet Amër bin Asit duke i thënë: "Habitem pse ende nuk e keni çliuar Egjiptin edhe pse me ata luftoni dy vjet, ky vonim i fitores, nuk është asgjë tjetër përpos rezultat i asaj që ju e keni dashur këtë botë sikur që e kanë dashur armiqët e juaj, Allahu nuk e ndihmon një popull përderisa nuk i ka qëllimet e pastërta, (sinqerta)".

Dhe lutja ime e fundit është:

O Zot ynë, mos i lejo zemrat tona të largohen pasi që na ke udhëzuar dhe shpërblena me mëshirën tënde! Ti je me të vërtetë shpërblyes i madh.

Enes Goga kl. IIIb

JETA E AMSHUAR - AHIRETI

Muslimani jeton në këtë botë, por nuk e harron edhe botën e amshuar. Ai e ka të qartë se s'është i krijuar të jetë një kohë e pastaj të zhduket apo siç mendojnë disa që shpirti i tij të kalojë në trupin tjetër. Jo, muslimani e ka të ditur se pas kësaj jete në këtë botë do të kalojë në jetën e amshuar. Botëkuptimi i tij është botëkuptim besimtari që e sheh me sy të ballit dhe me sy të zemrës...

"Zoti ynë, Ti je Ai që në një ditë do t'i tubosh njerëzit, ditë për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk shkel premtimin e Vet".

(Ali Imran: 9).

Besimi në ringjallje garanton sukses në jetën tjetër, dhe mbi të gjitha, jetën në këtë botë e bën plot paqë dhe kënaqësi, kështu që çdo njeri në vete e bën përgjegjës dhe të obligueshëm.

Mendo për arabët në kohën e injorancës, nuk besonin Zotin dhe mendonin se nuk ka jetë pas vdekjes, në atë kohë kur bixhozi, vera, luftërat e gjaqeve, vjedhjet dhe vrasjet ishin vetitë kryesore të tyre. Mirëpo, me ripërtëritjen e fesë islame me besimin në një Zoti dhe jetës tjetër (ahiretit), ata u bënë popull i më i civilizuar. Ata flakën veset e tyre të këqia dhe i zgjodhën mospajtimet duke u mbështetur në drejtësi dhe në Kur'an.

Me siguri ajo që i shtyn disa që të mos besojnë në ditën e fundit dhe jetën pas vdekjes është kjo se ata dëshirojnë të jetojnë pa përfillur kurrfarë norme, duke mos pasur kujdes ndaj të mirës dhe të keqës, duke mos iu frikësuar dënimit dhe dhënies së llogarisë, duke mos dëshiruar ringjalljen sikur që thotë i Madhi zot xh.sh.

"A mendon njeriu se nuk do t'i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t'ia tubojmë! Duke qenë se Ne jemi të zotët t'ia krijojmë siç kanë qenë edhe majat e gishtave të tij! Por njeriu dëshiron të vazhdojë edhe më-tej në mëkate".

(El-Kijame 3-5).

Pyetja se a ka jetë pas vdekjes, qëndron jashtë kufinjve të njohuri shkencore që vlejnë në radhitjen e analizave të të dhënave. Përveç kësaj, njeriu angazhohet për të hulumtuar dhe për të zbuluar shkencërisht, në kuptimin bashkëkohor të fjalës, ndërsa ai, tashmë që disa shekuj e njëj mirë konceptin (idenë) e jetës pas vdekjes që nga kohërat më të hershme. Të gjithë peygamberët i kanë ftuar bashkëkohësit e tyre për t'iu

dorëzuar Allahut dhe të besojnë në jetën pas vdekjes. Aty e kanë theksuar aq fort jetën pas vdekjes sa që dyshimi më i vogël në të do të ishte gënjeshtër dhe për ekzistimin e Allahut, kurse të gjitha predikimet e besimit do t'i bënin të pavlefshme.

Në një vend në Kur'an qëndron qartë se jobesimtarët nuk kanë argumente bindëse për të mohuar ringjalljen, sepse këto argumente bazohen vetëm në hamendje:

"Ata edhe thanë: Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë e jona në këtë botë, po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër përveç kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm fantazojnë. E kur atyre u lexohen ajetet Tona, të qarta, ata nuk kanë fakt tjetër, pos të thonë: nëse jeni të saktë na i sillni të gjallë prindërit tanë. Thuaj: Allahu juve ju jep jetën dhe ju bën të vdisni (e jo koha): mandej, do t'ju tubojë në ditën e gjykimit për të cilën nuk ka dyshim, por shumica e njerëzve nuk dinë (për fuqinë e Zotit)".

(El-Xhathijetu: 24-26).

Ata që mohojnë jetën e ardhme dhe ringjalljen pas vdekjes, e lënë pas dore dhe nuk përfillin fazën kryesore të jetës së njeriut, duke u përqëndruar në periudhën jetësore shumë të shkurtër, të cilën e përjetojnë në tokë...

Të këtillët janë aq në humbje sa Allahut i mohojnë fuqinë e ringjalljes. Këta e konsiderojnë se është absurde që njeriu të jetojë pas vdekjes. Ata këtë e konsiderojnë si funksion, i cili nuk ka kurrfarë baze...

Të këtillët vetë e përkufizojnë të pamurit e vet dhe qëndrimet e tyre i sjellin para pyetjes, sepse shikojnë në këtë jetë si në të vetmin realitet që ekziston. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

"Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se dëfrim, lojë, e jeta e vërtetë, padyshim, është ajo e botës së ardhme, sikur ta dini".

(El-Ankebutë: 64).

Muslimani beson se kur të vijë dita e ringjalljes engjëjt obligohen t'ia kthejnë shpirtin pasi që t'ia ketë marrë, dhe ata me atë rast do të sillen butësisht me besimtarin:

"Ata të cilëve duke qenë të pastër, engjëjtë ua marrin shpirtin, duke u thënë: *selamun alejkum, gjetët shpëtimin, hyni në xhennet, për hirë të asaj që vepruat*".

(En-Nahl: 32).

Pastaj shpirtin do t'ia bartin në qiell, ndërsa Allahu xh.sh. pranon veprat dhe shpërblen me mëshirë e falje...

Kur'ani i madhërueshëm jep skena dhe pamje të gjalla mbi përjetimet e llojllojshme të xhennetit dhe mbi vuajtjet e shumënumërta të xhehennemit.

Muslimani beson se fjala e Allahut xh.sh. është fjalë e vërtetë, prandaj është i patundur në këshillat dhe premtimet e Zotit xh.sh..

Premtimi i Allahut është (ky), Allahu nuk e then premtimin Vet, por shumica e njerëzve nuk po e dinë". (Er-Rum: 6).

Këto pamje banorëve të xhennetit u japin impresion kur të ndeshen me to, dhe kur të sjellin nëpërmend jetën e vet në këtë botë, duke i përkujtuar dhuntitë e Allahut xh.sh., të cilat u kanë mundur të shkojnë pas të vërtetës së njëmend dhe të cilat ua kanë përcaktuar rrugën e drejtë...

Dita e ringjalljes do të jetë ajo ditë kur virtytet e Allahut xh.sh. - drejtësia dhe mëshira do të manifestohen në tërësi.

Ekzistojnë edhe faktet bindëse për të besuar në ringjallje:

Një: Të gjithë të dërguarit e Allahut i kanë ftuar bashkëkohësit e tyre për të besuar në ringjallje.

Dy: Gjithmonë kur ndonjë shoqëri njerëzore është formuar në baza të këtij besimi, ajo ka qenë ideale dhe paqedashëse, e liruar nga problemet sociale dhe morale.

Tre: Historia vërteton se kurdoherë që ky besim është refuzuar kolektivisht nga një grup njerëzish, megjithatë që pejgamberët shpesh ua kanë tërhequr vërejtjen, tërë ky grup është dënuar në këtë jetë nga ana e Allahut xh.sh..

Katër: Mundësitë e pranimit real të njerëzve në aspektin shpirtëror, estetik dhe logjik e vërtetojnë realitetin, se ringjallja do të ekzistojë.

Pesë: Drejtësia dhe mëshira, si cilësi të Allahut do të ishin pa vlerë sikur të mos ekzistonte jeta pas vdekjes...

Bashkim Avdiu kl. IIIb.

TRI PYETJE DIJETARIT...

Një dijetar musliman ishte tërhequr në kopshtin e vet dhe nuk dille në mes të njerëzve.

Tre bashkëqytetarë të tij vendosën që ta përqeshin e ta nxisin. I shkojnë në vizitë dhe i parashtrojnë tri pyetja dhe atë secili nga një.

I pari: Ti pohon (thua) se ka Zot. Tregoma Zotin dua ta shoh Atë?

I dyti: Ti thua se në botën e ardhme do të dënohemi me zjarr. Exhinët janë krijuar nga zjarri. Si do të dënohet zjarri me zjarr.

I treti: Ti thua se çdo gjë ndodh me përcaktimin e Zotit. Çka do të thotë se njeriu nuk është përgjegjës për veprat e veta, e unë po shoh se njeriu po i krijon veprat e veta natyralisht.

Kur dijetari i dëgjojë këto tri pyetje, i mori tre grushta dhe, duke u hedhur në fytyrë, iku tha se kjo është përgjigja e tij në tri pyetjet e tyre. Një sjellje e tillë i ofendoi vizitorët, kështu që ata iu drejtuan kadiut që të gjykojnë në mes tyre.

Në gjykim, dijetari iu përgjigj kadiut:

I pari kërkoi që t'ia tregojë Zotin që ta shohë, në qoftë se është e vërtetë se Zoti ekziston. Ie të ma tregojë ai mua dhembjen që e ka ndjerë në fytyrë nga dheu, sepse dhembja ekziston.

I dyti thotë se nuk mund të ndjehet dhembje nga e njëjta materie, e para si e ndjen ai dhembjen nga dheu, kur edhe trupi i tij është nga dheu.

I treti thotë se njeriu i krijon veprat e veta, dhe nuk pranon vullnetin e lirë dhe mundim, e pse pra atëherë më akuzon?!

Në këtë përgjigje të të akuzuarit kadiu iu përgjigj akuzaesve:

"Mos e kaloni kufirin në paragjykimin e të kuptuarit të Qentes së Lartësuar të Zotit. Argumentet më të mëdhaja që Zoti ekziston kuptohen nga bota e cila na rrethon.

Ir fan Krasniqi kl. IIb.

MORALI ISLAM

Falënderimi i qoftë Allahut, të Mëshirshmit e Mëshirbërësit i cili ia dhuroi njeriut begatinë në të madhe prej begative të tij, i mundësoi njeriut të dallojë të mirën nga e keqja, të dobishmen nga e dëmshmeja, të drejtën nga e padrejta, i mundësoi të logjikojë të mendojë si dhe të jetë sundues i epsheve dhe udhëheqës i veprimeve të tij.

Shpëtimi dhe mëshira qofshin mbi Muhamedin a.s., shoket e tij dhe mbarë pasuesit e tij, i cili i zgjedhur nga ana e Allahut xh.sh. posedonte një moral të lartë dhe ishte shembull për çdo gjë, si në sjellje, edukatë, moral dhe përgjithësisht në jetë. Se Pejgamberi a.s. ka qenë i këtillë e vërteton fjala e Allahut xh.sh. ku thotë: *"Vërtet, ti (Muhamedi) je në një shkallë të lartë të moralit"* (el-Kalem: 4).

Sjellja, edukata dhe morali janë pjesë përbërëse të jetës së njeriut, janë pjesë të pandashme dhe pa to njeriu as që mund të mendohet kualitativ. Morali dhe edukata janë cilësitë më të rëndësishme për formimin e personalitetit islam dhe njerëzor, ashtu që nëse njeriu i posedon këto virtyte të larta e të lavdëruara, nëse gjendet në mes armiqve ose në mes atyre me të cilët ka lidhur marrëveshje, në të do të shohim tjetër person, jo në atë të cilin e njohin si shpifës dhe jotolerant, por në veprat dhe fjlët e tij shohin sinjeritetin, drejtësinë e besnikërinë sepse njeriu i tillë është pasqyrë e sinjeritetit dhe tolerancës. Njeriu ka mundësi të jetë kontrollues i veprimeve të tij, e të ndalohej nga veprat e pahijshme dhe amoralë të cilat shpiejnë drejt shkatërrimit dhe degjenerimit individual dhe shoqëror.

Morali islam mbështetet në parimin "mveshje me cilësi të mira dhe zhveshje nga veset e këqija". Për njeriun është e nevojshme të stoliset me çdo cilësi të mirë dhe t'i ikë çdo vesi të keq.

morali dhe edukata janë pjesë primare dhe elementare në jetën e njeriut ku thotë edhe Pejgamberi a.s.: "jam i dërguar për përsosjen e virtyteve të moralit".

Historia na mëson se njerëzit e mëdhenj shpirtërisht kanë qenë me karakter të pathyeshëm dhe moralisht të përkryer me virtyte të larta si në sjellje, moral, edukatë etj.

Ta kemi me dije se praktika ndikon më tepër te njerëzit se sa fjala, bën përmirësimin e njerëzve me sukses dhe i udhëzon ata. Ai që urdhëron në diçka që të punohet ai vetë duhet të jetë prijës në të dhe të jetë shembull. Lidhur me këtë Allahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Te Allahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni".

(Essaff: 2-3).

Lidhur me këtë kemi shembuj të shumtë nga e kaluara islame P.sh. marrim Omerin r.a. i cili kur urdhëronte njerëzit të punojnë diç, së pari vetë iu jepte shembull me punë para se t'u jepte shembuj me fjalë.

Rinia është koha më e bukur e jetës. Njerëzit e rinj me qëllime fisnike e me vepra të mira do të stolisin atë periudhë kohore shumë të bukur e të lulëzuar. E, rinia si është duke e stolisur, me çfarë veprash, jetën e vet. Te rinia kanë depërtuar vese të këqija si: amoraliteti, vjedhja, konsumimi i alkoolit e shumë vepra të tjera të ndyera, të cilat janë evidente në mesin e rinisë dhe janë bërë të zakonshme, pjesë të jetës. Mirëpo rinia kalon, të gjithë jemi dëshmitarë të rrjedhës së kohës, jemi dëshmitarë të ngjarjeve në të cilat koha del fitues. Çdo frymëmarrje është një hap drejt vdekjes. Me kalimin e kohës çdo gjë perëndon. Perëndojnë edhe njerëzit përveç Zotit xh.sh. i cili është i përjetshëm. Thotë Allahu xh.sh. *"Çdo gjë që është në të (tokë) është e zhdukur (kalimtare). E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i Madhëruar e i Nderuar. E, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"* (Er-Rahman 26-28).

Pra, rinia kalon shpejt. Secili le ta pyes vetveten se si është duke e kaluar këtë moshë, në çfarë mënyre? Me çfarë veprash? Ta pyesim vetveten në këtë botë para se të na pyes Allahu xh.sh. në botën tjetër.

Në fund të këtij mësimi modest për rrugën e vërtetë që udhëzon kah lumturia, shtrohet pyetja për rininë, se ç'mendon për të ardhmen?! A thua mendon për një të ardhme të lumtur e të begatshme? Në qoftë se mendon për një të ardhme të tillë, le të shikojë se ç'është duke bërë! Si është duke vepruar, me çfarë morali, me çfarë edukate, me çfarë sjellje etj.

A thua mendon për qëllimin më të lartë njerëzor, për qëllimin e përsosjes së tipareve fisnike. T'i lutemi Krijuesit të çdo gjëje të na ndihmojë, e popullit tonë t'ia mbjellë në zemër atë që është e mirë, atë e cila shpie drejt ndërrimit të kësaj gjendjeje.

Të jemi ajo rini që i themi vetes ndal se e ke gabim, e të drejtohem drejt rrugës më progresive. Ti' mveshemi punës dhe diturisë univerzale, e të largohemi nga veseset - ngacmimet e shejtanit. Allahu xh.sh. thotë: *"Me të vërtetë Allahu nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli, derisa ai popull mos ta ndryshojë vetveten"*.

Adnan Simnica kl. IIIa.

Prof. dr. Jusuf Kardavi

FETVA BASHKËKOHORE

(Pyetje-përgjigje)

1. Pyetje: - Në lidhje me voglushët (të vegjël), ju pyes kur janë të obliguar të agjërojnë, e kur të voglat (vogëlushet) dhe - sipas rregullave të sheriatit - a ekzistojnë vite të caktuara për të?

Përgjigje: - Në hadithin e të dërguarit a.s. thuhet:

"Nuk janë përgjegjës tre perësona:

- i mituri, derisa të arrijë moshën madhore,

- ai i cili flen, derisa të zgjohet, dhe

- ai i cili e ka humbur vetëdijen, derisa të kthjellet.
(Ahmedi, Ebu Davudi, Nesaiu, Ibën Maxhe dhe Hakimi prej Aishes r.a.).

Nuk janë përgjegjës të miturit, edhe pse islami si fe e cila në përgjithësi kujdeset për natyrën e njeriut dëshiron që prej rinisë më të hershme t'i mësojë të vegjël në ibadet dhe nënshtrim Allahut xh.sh. që të ushtrohen dhe stërviten në praktikimin e tij.

Për namazin Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Urdhëroni fëmijët tuaj që ta kryejnë faljen kur ata janë në moshën shtatëvjeçare, ndërsa kur t'i mbushin 10, detyroni ata që ta kryejnë atë"*. (Ahmedi, Ebu Davudi, Hakimi prej Abdullah ibën Amër ibën Asit).

Agjërimi është sikurse namazi, lloji i ibadetit dhe obligim ndaj Allahu xh.sh. Jemi të urdhëruar që t'i mësojmë fëmijët në të. Por kur të fillohet? Nuk është e domosdoshme që kjo të jetë në moshën 7 vjeçare, sepse për të agjëruar është shumë më vështirë se sa për t'u falur, që do të thotë se çdo gjë varet nga shkathtësit e vet fëmijut. Kurdo që prindi apo kujdestari shoh se fëmiju mund të agjërojë, qoftë ajo edhe vetëm disa ditë të çdo muaji, - le të fillojë që të mësojë.

Do të mësojë gradualisht, vitet e para le t'i agjërojë tri ditë, vitet e dyta nga një javë, të tretat dy javë, e pas kësaj tërë muajin, kështu që kur të vijë moshë e pjekurisë, e ajo është koha e obligimeve, do të jetë i mësuar në agjërim, dhe ai nuk do t'i paraqesë vështirësi. Kjo është mënyra e edukimit që fëmiju prej vegjëlisë, prej fëmijërisë së hershme,

t'i pranojë dhe njoftohet me moralin dhe urdhërat islame, që të mësohet në to me lehtësi.

Për këtë është obligim i prindërve që djemët dhe vajzat e tyre t'i mësojnë në namaz dhe agjërim. Në namaz prej moshës 7 vjeçare, ndrsa në 10 munden që t'i detyrojnë në këtë, derisa me agjërimin duhet filluar atëherë kur fëmiju është i aftë për këtë në moshën 8, 9 ose në njërën prej viteve më të vonshme, varet prej shkathtësive të tija personale.

2 Pyetje: Pas sa kilometrave të kaluara njeriut i bëhet e lejuar që të mos agjërojë, a është kjo vërtet 81 km.? A e ka të lejuar të agjërojë, nëse mund t'i përballojë udhëtimin?

Përgjigje: Udhëtari duhet të hajë në bazë të citatit të qartë të Kur'anit a.sh.:

"...E kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (nuk agjëron), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë".
(El-Bekare: 184).

Për vetë gjatësinë e rrugës juristët islamë janë ndarë. Megjithatë për këtë gjatësi, të cilën e përmend lexuesi ynë, sipas mendimit tim të gjithë pajtohen. Gjatësia e rrugës është e kufizuar, për shkurtimin e namazit dhe prishjen e agjërimin, te shumica e shkollave juridike në 84 km. Megjithatë këto përkufizime janë relative. Nuk ceket se i dërguari i Zotit a.s. e as sahabët (shokët e tij) të kenë përcaktuar gjatësinë në metra apo km. Megjithatë kjo gjatësi mjafton, edhe pse disa dijetarë islam fare nuk kushtëzojnë të ngrënit me gjatësinë e rrugës, sepse çdo udhëtim konsiderohet udhëtim edhe nga aspekti gjuhësor e edhe shiquar nga rregullat e traditës në të është i lejuar edhe shkurtimi i namazit njëjtë sikur që është e lejuar për agjëruarin të hajë. Këtë e ka institucionalizuar edhe vetë Kur'ani e njashtu edhe sunneti i të dërguarit a.s.

E vet udhëtari mund të zgjedhë. Shokët e të dërguarit a.s., kur udhëtonin me të, e në mesin e tyre kishte agjëruar, por, edhe të tillë që nuk agjëronin, E as ai i cili ka ngrënë nuk iu është kundërvënë agjëruarit, e as e kundërta agjëruarit atij i cili ka ngrënë. por ta kemi ndërmend: udhëtari i cili me vështirësi të madhe agjëron agjërimi i tillë është mekruh, e në disa raste është haram, në bazë të fjalëve të Muhamedit

a.s. kur e pa njeriun të cilit bashkudhëtarët e tij i bënë hije, sepse me vështirësi e përballonte agjërimin. I ka pyetur se çka ka, e kur iu kanë përgjegur se bëhet fjalë për agjëruesin, Muhamedi a.s. theksoi: *"Nuk është mirësi që të agjërohet në rrugë"*. (Buhariu).

Kjo ka të bëjë me atë të cilit agjërimi i sjell vështirësi, ndërsa ai i cili e përballon me lehtësi, ashtu siç kemi thënë, mundet të zgjedhë; se a do të agjërojë apo jo, por të pyetemi se çka është më mirë?

Dijetarët janë ndarë rreth kësaj pyetje: disa preferojnë agjërimin e disa të ngrënit.

Omer ibën Abdul Azizi thoshte: "Ajo që është më lehtë, është më mirë". Disave u është më lehtë të agjërojnë së bashku me të tjerët, që mos t'i duhet t'i kompenzojnë ditët e humbura, kur të tjerët të hanë e të pinë.

Të tillëve mund t'i u themi: "Agjëroni!".

Megjithatë, e kanë më lehtë për të mos agjëruar, sepse duhet kryer disa punë të domosdoshme, e që t'i kryejnë me lehtësi, iu preferojmë: "Hani dhe agjëroni numër të njëjtë ditësh më vonë", ajo që është më e lehtë për personin, ajo është edhe më me vlerë.

Ebu Davudi transmeton nga Hamza bin Amri El-Kalemi se ka thënë: Nganjëherë me befason ky muaj, e ndihem mirë, jam i ri, dhe mendoj se e kam më lehtë, o i dërguar i Zotit, që të agjëroj menjëherë, se sa ta lë më vonë si borxh. Pra a ta agjëroj dhe a do të jem më shumë i shpërblyer, se sa të ha?".

Çka të duash, Hamza - tha i dërguari i Zotit, d.m.th. zgjidhe atë që është më lehtë.

Në tjetër transmetim të cilin e citon Nesaiu, gjithashtu, nga Hamza bin Aziz El-Eslemiu, thuhet se e ka pyetur të dërguarin e Zotit a.s.: - "A do të gaboje, nëse agjëroj në rrugë, edhe pse ndihem i aftë për të?".

- Ajo është lehtësim i Allahut për ty, kush e pranon mirë ka vepruar e kush më tepër dëshiron të agjërojë, nuk ka në të ndonjë mëkat.

Kjo është dispozita e Allahut mbi udhëtimin. Megjithatë, nuk është e nevojshme, e as kusht që për këtë lehtësim vështirësitë të jenë të pakalueshme apo që thjeshtë të realizohen. Vetë udhëtimi është arsye e mjaftueshme që të mos agjërohet. Allahu xh.sh. nuk e ka kushtëzuar lehtësimin me vështirësi, por vetëm me udhëtim. Të ishte dispozita e kushtëzuar me vështirësi, do të vinte deri te ndarja e madhe

në mes njerëzve. Disa do të agjëronin në vështirësitë më të mëdha dhe krahas kësaj do të thonin: "Nuk është kjo kurrfarë vështirësie", dhe do t'i ngarkonte atë që do t'i shkatërronin dhe do t'i sillnin mundim, e Allahu xh.sh. nuk dëshiron t'i mundojë robërit e Tij.

Ata më labilët edhe ngarkesën më të vogël do ta kuptojnë si vështirësi. Për këtë dispozitën mbi të ngrënit në udhëtim Allahu xh.sh. e ka kushtëzuar me vetë udhëtimin. Prandaj edhe në qoftë se njeriu udhëton me aeroplan, tren apo veturë, ai lirisht mundet me ngrënë meqë duhet më vonë t'i agjërojë numrin e njëjtë të ditëve. Nga ai plotësisht bie obligimi i agjërimin, porse vetëm shtyhet derisa t'i ipet mundësia e parë. Për këtë ai mund të zgjedhë në atë moment, edhe nëse udhëtimi nuk i sjell vështirësi.

Ata të cilët kanë udhëtuar e dinë se udhëtimi, nga vetvetiu është një lloj derimi, pa marrë parasysh udhëtoi njeriu në kafshën bartëse apo aeroplan. Vetë largimi i njeriut nga vendlindja e tij, nga familja e tij, bën që ai të ndihet jonatyrshëm, i parahatshëm dhe i shqetësuar. Për shkak të këtyre lajmërimeve psikike, e jo vetëm fizike, Allahu xh.sh. e ka obliguar të ngrënit në udhëtim si dhe dispozitat tjera, për të cilat jemi apo nuk jemi të vetëdijshëm.

Mjafton që të jemi të kënaqur me citatin e qartë të Kur'anit a.sh. e jo më gjerësisht të thellohem në teori.

Nuk duhet lejuar veti këtë, Allahu xh.sh. thotë:

"me këtë Allahu ju dëshiron lehtësim e jo vështirësi".

3. Pyetje: A do të jetë në rregull (i pranuar) agjërimi, nëse agjëruesi përgojon, gënjen apo shiqon me epsh femrat (gratë) tjera?

Përgjigje: Agjërimi i cili bën dobi dhe i cili në dashtë zoti do të jetë i pranuar, është ai i cili e pastron shpirtin, forcon dëshirën për kryerjen e veprave të mira, shkakton devotshmërinë e përmendur në ajetin vijues:

"O ju të cilët keni besuar, u është bërë obligim agjërimi sikur që iu është bërë obligim atyre para jush, në mënyrë që të jeni sa më të devotshëm".

(El-Bekare: 183).

Është obligim i agjëruesit që të përmbahet prej çfarëdo lloji bisede, ose reagimi i cili mund t'i bëjë dëm agjërimin të tij, që prej tij të mos ketë vetëm uri dhe etje. Në hadith thuhet:

"Agjërimi është mburojë, prandaj kur ndonjëri nga ju agjëron le të mos tallet me fjalë të paturpshme dhe mos ta

ngrit zërin, e nëse dikush e fyen ose dëshiron të rrahët, le të thotë: "unë agjëroj". (Buhariu dhe Muslimi).

"Shumë prej agjëruesve kanë vetëm uri, e shumë nga falja e tyre e natës kanë vetëm pagjumësi". (Ibën Maxhe, Nesaiu, Hakimi).

"Kush nuk e braktis (lë) rrenën dhe përdorimin e saj, atëherë Allahu xh.sh. nuk kërkon prej tij ta braktisë (lë) as ushqimin e pijet". (Buhariu, Muslimi).

Ibën Arebi thotë: "Porosia e këtij hadithi është se personi i tillë nuk do të jetë i shpërblyer për agjërimin e tij, d.m.th. se shpërblymja për agjërim nuk do të vendoset në mizan (peshojë) se bashku me mëkatet e rrenës e të ngjashme me të.

Ibën Hazmi konsideron se mëkatet e tilla e prishin agjërimin, njashtu siç e prish të ngrëniet dhe të pirat. Ekzistojnë fjalë të disa as-habëve dhe tabi-inëve prej të cilëve ky mendim do të mund të derivohej.

Ne konsiderojmë, edhe nëse e refuzojmë qëndrimin e ibën Hazmit, se këto mëkate shkatërrojnë frytet e agjërimit dhe prishin qëllimin për të cilin në të vërtetë është obliguar.

Për këtë muslimanët e parë janë përmbytur nga të folurit e paturpshëm dhe çdo sendi tjetër të ndaluar, ashtu siç janë përmbytur nga ushqimi dhe pijet. Omeri r.a. ka thënë: "Nuk duhet agjëruar vetëm nga ushqimi dhe pija, por edhe nga rrena, të folurit e paturpshëm dhe çdo gjë që është e keqe". Aliu r.a. ka thënë diç të ngjashme me këto fjalë, kurse fjalët e Xhabirit r.a. janë:

"Kur të agjërosh, le të agjërojë dëgjimi yt, të shiquarit dhe gjuha nga gënjeshtria dhe mëkate tjera. Mos i maltreto shërbëtorët tu. Bëhu i qetë dhe modest kur të agjërosh. Mos të jenë të njëjta ditët si kur të agjërosh si kur të hash".

Ebu Dherri r.a. i thoshte Talik b. Kajsit: "Kur të agjërosh, ruaju sa të mundesh". Taliku gjatë kohës së agjërimit, mbyllej në shtëpi dhe dëltë vetëm për kryerjen e namazeve".

Ebu Hurejra me shokët e vet, gjatë kohës së agjërimit, ulej në xhami dhe atëherë thonin: "Po e pastrojmë agjërimin tonë".

Mejmunë b. Mehrani ka thënë: "Agjërimi më i dobët është abstenimi vetëm nga ushqimi dhe pijet".

Pa marrë parasysh nëse themi se veprat e këqia prishin agjërimin apo jo, duhet ta kemi ndërmend se çdo vepër do të vlerësohet dhe matet mirë: sepse... "Zoti im nuk gabon e as nuk harron" (TA-HA:52).

Mendo për hadithin vijues të Pejgamberit a.s. për precizitetin dhe saktësinë e llogarisë së Allahut në Ahiret, dhe aty do të gjeësh përgjigjen adekuate në pyetjen e parashtruar.

Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu nga Aisheja r.a. se njëri prej as-habëve të Pejgamberit a.s. u ul pranë tij dhe tha:

- "O i dërguari i Allahut, i kam dy shërbëtorë të cilët më rrenjnë dhe bëjnë mëkat ndaj meje, e unë i dënoj fizikisht dhe i qorto, e në çfarë proporcioni (marrëdhënie) do të jem me ta ditën e gjykimit".

I dërguari i Zotit s.a.v.s. i tha:

"Do të llogaritet ajo ku të kanë mashtruar, ku të kanë bërë mëkat, e pastaj ndëshkimi yt ndaj tyre, e nëse është ndëshkimi yt më i dobët nga mëkati i tyre ndaj teje do të jesh në përparësi ndaj tyre; e nëse ndëshkimi yt ndaj tyre është i barabartë me mëkatet e tyre, nuk do të jesh as i shpërblyer e as i ndëshkuar; e nëse ndëshkimi yt ndaj tyre është më i fortë se sa mëkatet e tyre, do të mirren prej teje veprat e mira dhe do t'u ipen atyre, atëherë njeriu filloi të bërtasë e të qajë para të dërguarit s.a.v.s., e ky i tha:

- "Çka ke, a nuk ke lexuar në librin e Allahut:

"Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa peshoja e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës". (El-Enbija: 47).

Atëherë as-habi tha:

- "O i dërguar i Allahut, më së miri do të bëhet që të ndahem nga këta dy. Të marrë për dëshmitarë se po i lirojë nga robëria".

PËRKTHEU: nga revista "Islamska misao".

Enis Rama

XHAMIA DHE XHEMATI

(thënie të pejgamberit)

1. Kush ndërton xhami në emër të Allahut, atij Allahu do t'ia ndërtojë një xhami të këllullë në xhennet.

2. Xhamitë, ku falen dhe i bien në sexhde Allahut xh.sh. janë vendet më të dashura të Allahut xh.sh. në tokë.

3. Kur njeriu falet në xhami, me xhemat, melaikët e rrothojnë dhe bëjnë dua të Allahut xh.sh. për të: O Zoti ynë, krij mëshirë ndaj krijesës sate që të është përkushtuar. Fale dhe merre nën mbrojtjen Tënde.

4. Kur e shihni njeriun se e ka bërë shprehur të shkojë në xhami, për të mund të dëshmoni se është besimtar i vërtetë - mu'min.

5. Sikur ta dinin njerëzit se ç'të mira, fat dhe bereqet tshihen në kohën e namazit të sabahut dhe të jacisë, do të vinin në xhami qoftë edhe duke u zvarritur.

6. Sihariqo ata që nëpër errësirë shkojnë në xhami (Të falin namazin me xhemat), me dritën e plotë-nur në ditën e gjykimit.

Nga "dituria Islame" shkëputi:

Bashkim AVDIU kl.IIIb.

KUR'ANI MREKULLIA E AMSHUESHME

Shpallja e udhëzuar për njerëzit nga Allahu përfundoi me Kur'anin. Kur'ani nuk është as shpallja e parë e as e vetmja, veç e fundit dhe përfundimtarja në vargun e shpalljeve që iu shpallën popujve të ndryshëm napërmjet pejgamberëve.

Kur'ani padyshim është fjala e Zotit i cili në formë të shpalljes iu dërgua Muhamedit a.s., në intervale të caktuar kohore brenda periudhës 23 vjeçare, duke filluar në Mekke (610-622), dhe në Medinë (622-632). Ai është porosi e Zotit që ka për qëllim t'i vendosë themelet e jetës së gjithmbarshme të individit dhe bashkësisë, prej lindjes deri në vdekje, në të gjitha hapësirat gjeografike, deri në fund të botës. Për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira dhe injoranca për t'i shpjerë në dritë në rrugën e drejtë. Thotë Allahu xh.sh.:

"Ne të shpallëm me urdhërin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë në rrugë të Fuqiptotit të Falënderuarit".

(Ibrahim: 1).

Sado që të flitet e të shkruhet për Kur'anin, njeriu nuk do të arrijë ta thotë fjalën e fundit. Ai është i pakrahasueshëm me çfarëdo vepre sepse burim i tij është Allahu, ndërsa Muhamedi a.s., ishte transmetues i fjalës së Allahut. Për sa i përket faktit se Kur'ani është fjalë e Allahut flet edhe ky ajet:

"Nuk ka dyshim se ti (Muhamed) je duke e pranuar Kur'anin nga vetë i Urti dhe i Dijshmi"

(En-Nem 16).

Allahu xh.sh., në katpinën El-Isra:9, thotë:

"Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë atë rrugë që është më e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh".

Kur'ani është i vetmi udhëzim në rrugën e vetme të drejtë e më të sigurtë. Ai erdhi që të jetë stil i jetës, që të realizojë rendin e Allahut në botë. Muslimanëve u premtonte dhe u siguron jetë të qetë, të lumtur pa brengë. Vuri themelet e besimit në një Zot, bëri kthesa në marrëdhënie ndërinsore dhe ndërmjeshore. Kultivon dashuri dhe mbjell frymë paqeje ndër njerëz, rrëfen për popujt e lashtë, për dunjan, ahiretin etj.

Pra, Kur'ani si fjalë e Allahut, leximi i të cilit është adhurim ku thotë Pejgamberi a.s.: **"Kush dëshiron që me Zotin e tij të bisedojë, le të lexojë Kur'anin"**, gjithnjë është në shërbim të njeriut.

Kur'ani përmban veti të vërteta, të cilat duhet besuar edhe para se t'i kuptojë mendja, sepse shumë çështje që i ka cekuar Kur'ani, shkencën ka arritur t'i kuptojë më vonë.

Edhe pse nuk guxon të konsiderohet doracak shkencor megjithatë në të mund të gjejmë edhe fakte shkencore. Kur'ani flet për rolin e erërave dhe thotë:

"Ne i lëshuam erërat mbarësuese".

(Hixhr: 22).

Ka dhënë shenjë për rrotullimin e tokës:

"... dhe i sheh kodrat mendon se janë të palëvizshme ndërsa ato lëvizin si retë"

(En-Neml: 88).

Për ta zotëruar natyrën domosdo nevojitet dituri, sepse sipas Kur'anit mosdija është plagë e rëndë, për këtë arsye në ajetin e parë të Kur'anit urdhërohet:

"Lexo, studio në emër të Zotit tënd".

(El-Alek: 1).

Kur'ani është mrekulli e përjetshme e cila ishte dhe vazhdimisht do të jetë dëshmitare e pejgamberllëkut të Muhamedit a.s.. Nëse mrekullitë e mëparshme kishin ardhur për një kohë të caktuar, Kur'ani është veçuar nga të gjitha ato si e përjetshme sepse islami është fe e përjetshme dhe definitive. Nëse ato mrekulli kanë qenë të kufizuara për një popull, mrekullia e Kur'anit është e përgjithshme.

Mrekullia e Kur'anit është prezente si në pikëpmaje gjuhësore gjithashtu edhe në atë kuptimore. Rrjedhshmëria, stili i tij i lartë gjuhësor bëri që të gjuhëzohen para tij poetët më të aftë, tërhoqi vëmendjen pa marrë parasysh se a i takon besimit islam apo jo. Është e natyrshme që Kur'ani të jetë i tillë sepse për të Zoti xh.sh., në librin e Tij thotë:

"Thuaj atë e zbriti Ai që di të fshehtë në qiejë në tokë".

(Furkan: 6).

Duhet të edukohemi nën hijen e parimeve kur'anore, duke i kryer urdhërat e tij dhe duke u frenuar prej të gjitha ndalimeve që ai i ka caktuar. Me një fjalë e gjithë jeta jonë duhet të jetë në harmoni me këkesat kur'anore. Lidhur me këtë kemi shembull sahabet, i kanë mësuar dhjetë ajete, nuk shkonin më tutje përderisa nuk i jetësonin në praktikë. Sahabët nuk e mësonin kur'anin për t'u informuar teoritikisht, por atë e mësonin për ta përqafuar imperativin e Allahut në pikëpamje të jetës dhe detyrave të tij.

E përqafonin për të filluar menjëherë ta praktikojnë. Vazhdimisht e përqafonin Kur'anin dhe vazhdimisht e realizonin konceptin e tij. Hasan El-Basri ka thënë: "Ata para jush kur'anin e shihnin si broshura nga Zoti i tyre. Gjatë natës e kanë studiuar dhe analizuar, ndërsa gjatë ditës e kanë zbatuar në jetën praktike".

Ata i qaseshin Kur'anit ashtu si kërkon dhe lejon, ai i bashkonte, i përmirësonte jetën e tyre, u jepte përgjigje ashtu që i ndjenin se po jetojnë nën mbrojtjen e Zotit. Muhamedi a.s., u jepte shembull praktik si duhet jetuar dhe punuar, si të luftohet dhe si duhet të jenë të durueshëm.

Të jemi të durueshëm, islami le të na jetë rrugë e jetës kurse Allahu dhe kënaqësia e Allahut cak përfundimtar.

Artan Zeka kl. IVa

SYNETI - TRADITA E PEJGAMBERIT a.s.

Është vendim kompakt dhe i padiskutuar në mesin e dijetarëve se syneti - tradita e Muhamedit a.s., është burim i dytë i sheriatit. Me fjalën synet nënkuptojmë çdo vepër, fjalë apo miratim nga ana e pejgamberit a.s. Për rëndësinë e këtij burimi flasin shumë ajete dhe hadithe. Në lidhje me këtë Allahu xh.sh., thotë:

Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju do juve, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahut është që fal shumë mëshiron shumë" Ali Imran: 31.

Prej këtij ajeti nënkuptojmë se dashuria e Allahut nuk arrihet ndryshe, por vetëm duke e dëgjuar Pejgamberin a.s. dhe duke e praktikuar traditën e tij, i cili nuk ishte gjë tjetër vetëm se sqarues dhe komentues i fjalës së Allahut xh.sh.. Pejgamberi a.s. thotë:

"Ai i cili më pason mua ai dhe më do mua, e ai i cili më do mua do të jetë së bashku me mua".

Krahas ajeteve dhe haditheve që trajtojnë këtë tematik kemi edhe thëniet e dijetarëve të cilët kur janë pyetur për këtë çështje dhanë këtë mendim të unjësuar: Synetit nuk duhet qëndruar përballë por duhet t'i nënshtroheni dhe dorëzoheni. Ai i cili e mohon synetin si burim i dytë i sheriatit nuk konsiderohet se është musliman ai llogaritet se ka dalë nga islami dhe iu ka bashkangjitur pabesimtarëve.

Ky është mendim kompakt i të gjithë dijetarëve islamë dhe se nuk ka fuqi e cila mund ta thejë këtë vendim të gjeneratave të hershme.

Kur dikush vinte te Ebu Bekri r.a. që të gjykojë në një çështje ai shiqonte së pari në Kur'an dhe argumentonte me të, e nëse nuk gjente zgjedhje pyeste sahabët se a mos dinë dikush se si ka gjykuar Pejgamberi a.s. në atë problem. Dhe thoshte: Falënderuar qoftë Allahu i cili ka bërë njerëz që e ruajnë fenë tonë. Aliu r.a. kur ishte pyetur për fshehtësinë e dijës së tij të madhe që e posedonte, kishte thënë: "As që më shpallet vahji nga Zotit xh.sh. e as që jam Pejgamber por punoj sipas Kur'anit dhe synetit aq sa mundem".

Abdullah ibn Omeri r.a. i cili pothuajse më së shumti u mudua të ecë shtigjeve të pejgamberit a.s.. Më një rast duke udhëtuar me karavanë kur arriti tek një vend, u ndal dhe ktheu kokën anash dhe shiqoi. Kur është pyetur se për çfarë

arsye e bëri këtë është përgjigjur "Në këtë vend e kam parë Pejgamberin a.s. duke bërë kështu, prandaj edhe unë dëshiroj që ta bëjë të njëjtën. Ky sahab i shquar nuk pyeti se kjo vepër a është porosi apo urdhër i Pejgamberit a.s. por atij i mjaftoi që Pejgamberi a.s. kështu kishte vepruar qoftë rastësisht apo qëllimisht.

Jo vetëm ky por të gjithë ashabët e më vonë edhe tabiinët ishin të rreptë në zbatimin e urdhërave dhe porosive qofshin ato nga Kur'ani apo nga syneti. Shumë herë ka ndodhur të bëjë një punë sipas dijes që e kanë disponuar por më vonë nëse janë lajmëruar se Pejgamberi a.s. ka vepruar të kundërtën menjëherë janë kthyer nga mendimi i tyre.

E tillë ishte gjenerata e parë dhe për këtë korren sukses dhe fituan epitelin gjenerata më e mirë e muslimanëve. Një prej dijetarëve të mëdhenjë të kohës së tabinëve i quajtur me emrin Hasan el Basri shprehet kështu: "Nuk vlen fjala pa punë, dhe gjithashtu nuk vlen as fjala e as puna pa pasur qëllimin e mirë, por të gjitha këto nuk vlejnë nëse nuk janë në përputhje me sunnetin".

Prandaj për të qenë gjithnjë në rrugën e vërtetë dhe duke mos devijuar dhe humbur asnjëherë nga kjo Pejgamberi a.s. në haxhin e tij lamtumirës ndër tjerash na porosit edhe me këto fjalë:

"Ju kam lënë juve dy gjëra: kurrë s'do të jeni të humbur, nëse u përmbaheni: Librin e Zotit - Kur'anin, dhe sunnetin e Pejgamberit a.s.".

Prandaj duke pasur parasysh gjithë atë që tham më lartë mudn të konkludojmë se të gjithë muslimanët duhet gjithnjë t'u përmbahen udhëzimeve të cilat vijnë nga Kur'ani apo sunneti. Muslimanët duhet gjithnjë që në punët e tyre fetare të bazohen së pari në këto dy burime kryesore që janë padyshim Kur'ani dhe hadithi. Dhe për fund lusim Allahun xh.sh. që të na drejtojë drejt rrugës së cilës eci i dërguari i Zotit dhe shokët e tij, që të dërguarin e Allahut ta kemi të vetmin shembull dhe mostër për jetë.

Allahu na bashkoftë në xhennet me shoqërinë më të mirë që janë Pejgamberët, të singertit, dëshmorët dhe burrat e mirë.

Bashkim Bajrami kl. IVa.

VLERA E SHFRYTËZIMIT TË KOHËS

Për të arritur përsosshmërinë e shpirtit, duhet që t'i plotësojmë disa kushte të cilat nuk janë të rënda për asnjë musliman e muslimane. Njëra nga këto kushte është shrytëzimi maksimal i kohës duke marrë parasysh vlerën e saj.

Ne e dimë se kjo botë është kalimtare, dhe se ne qëndrojmë në të për një kohë të shkurtër e të kufizuar. Çdo orë, çdo minut, çdo sekond për ne paraqet një vlerë, pra, ne nuk guxojmë ta kalojmë kohën kot. Planifikimi i jetës për ne është një detyrë jashtëzakonisht serioze, kurse vdekja është dëshmitare e heshtur e këtij serioziteti fisnik.

Allahu xh.sh. në Kur'anin e madhëruar betohet në kohën në ajetin e parë të sures El-Asr duke thënë "Pasha kohën". Ka edhe shumë ajete e hadithe që i kushtohen kohës dhe vlerës së saj. Muhamedi a.s. ka thënë: Allahu le të mos ma bekoj asnjë ditë në të cilën nuk mësoj diçka të re". Nga hadithi kuptojmë se vetë Muhamedi a.s. i ka dhënë rëndësi të madhe kohës. Është e preferuar që kohën ta kalojmë sa më shumë në mësim dhe adhurim (ibadet). Bile duhet ta shfrytëzojmë përveç ditës edhe natën. Allahu xh.sh. thotë:

"E s'ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë" (Muzemmil: 5).

Dhe falu për hirë të Tij në një kohë të natës, mandej adhuroje ATë edhe natën më gjatë" (El-Insan: 26).

Një thënie e urtë angleze thotë: "Koha është flori". Kjo është e vërtetë, por koha është edhe më shumë se kjo. Koha është dhuratë nga Allahu xh.sh. dhe çështje themelore e jetës së njeriut.

Nëse hyjmë në ndonjë bibliotekë, do të çuditemi duke parë aty libra të shkrimtarëve të ndryshëm. Menjëherë do të pyesim vetëm si ka arritur ky njeri ta shrytëzojë kohën në mënyrë kaq të mençur?

Ne sot njohim shumë dijetarë islamë, të cilët i kanë kushtuar rëndësi të madhe kohës. Ata, sot janë të njohur e ta afrimuar në gjithë botën si: Ibën Halduni, Ebu Zekerija Err-Rrezu, Ibni Sina, Gazaliu, Ebu Hanifeja, Maliku, etj.

Në një orë të vjetër në Oksford shkruan: "Koha po kalon por për të jepet llogari". Dhe me të vërtetë, ne jemi përgjegjës për kohën, sepse askush nga ne nuk e di se kur do të vijë çasti i vdekjes.

Në vazhdim po japim disa mendime të dijetarëve botërorë lidhur me kohën; Shekspiri ka thënë: Kapë momentin për balluke! Kuintiliani ka thënë: "Shpeshherë, derisa të mendoj se si t'ia filloj një punë bëhet tepër vonë". Hasan Basriu shkruan: "O njeri, dita jote është musafiri yt, i cili do të lë. Në fund ose do të falënderojë ose do të përgojojë". Dy fjalë të urta arabe thonë: "Koha është si shpata, nëse nuk e pret ti atë, të pret ajo ty" dhe "katër gjëra nuk mund të kthehen kurrë: fjala e thënë, shigjeta e hedhur, koha e kaluar dhe rasti i shfrytëzuar".

Pra ta shfrytëzojmë në kohën e të mos na shfrytëzojë ajo neve.

Lulzim Blaka kl. IIa

DISA STATISTIKA RRETH KUR'ANIT

- Kur'ani Fisnik ka gjithësejt 114 kaptina;
- Numri i ajeteve të Kur'anit sipas Ali ibn Ebi Talibit është 6236;
- Numri i fjalëve të Kur'anit sipas Ataut është 77439;
- Numri i shkronjave të Kur'anit sipas Ibn Abbasit është 323671
- Kaptina më e gjatë e Kur'anit Fisnik është kap. "El-Bekare", e cila gjithsejt ka 286 ajete;
- Kaptina më e shkurtër e Kur'anit Fisnik është kap. "El-Kevther", e cila ka gjithësejt 3 ajete;

- Ajeti më i gjatë i Kur'anit është ajeti i 282 i kaptinës "El-Bekare", i cili ka 128 fjalë;
- ajeti më i shkurtër i Kur'anit është ajeti "Ved-Duha", "Vel - Kamer" dhe "Ta ha";
- fjala më e gjatë në Kur'an është "Festekina kemuha" dhe "Iktereftumuha";
- Fjala më e shkurtër në Kur'an është: "Kaf", "Nun" dhe "Sad".
- Fjala e Kur'anit "Vel-jtelettaf" e cila gjendet në ajetin e 19 të kaptinës "El-Kehf" shënon mesin e Kur'anit Fisnik.

Përgatiti: Irfan Mehmeti

SHEMBULLI I NJERIUT TË JASINIT NË XHENNET

"Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri që ngutej e tha: "O populli im, dëgjoni të dërguarit!" Dëgjoni atë që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes! E, ç'kam unë që të mos adhuroj Atë që më krijoi dhe te Ai ktheheni. A do të pranoj zota tjerë pos Tij, e nëse do Mëshiruesi të më godas me ndonjë të keqe, ndërmjetesimi i tyre nuk do të më vlej asgjë, e as që do të më shpëtojë. Unë do të jam atëherë në një humbje të haptë. Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni!" Atij i është thënë: *"Hyr në xhennet!" e ai tha: Ah sikur të dinte populli im, për çka më fali Zoti im, dhe më bëri prej të nderuarve!"* (kap. Jasin, ajeti 20-27).

Njeriu që erdhi prej skajit të qytetit ishte besimtar i devotshëm dhe përkrahës i denj i të dërguarve të atij populli. sipas shumicës së komentatorëve të Kur'anit fshati ishte Entakije e të dërguarit Sadku, Maduku dhe Shemuni, ndërsa njeriu i mirë Habib Nexhari, i cili thirrri popullin e tij në rrugë të drejtë dhe që t'i dëgjojnë të dërguarit e tyre, derisa edhe dha jetë për hirë të së vërtetës. Ai, popullit të vet iu drejtua duke i thënë: O popull, për juve është të dëgjuarit e të dërguarve të cilët kanë ardhur me çdo të mirë që dëshironi, kanë ardhur me atë që i ka dërguar Allahu xh.sh... O popull, dëgjone atë i cili nuk kërkon për komunikimin e shpalljes ndonjë shpërblim, e as nuk kërkon nga ju të mira. po vetëm e vetëm që t'ju udhëzojë në rrugë të drejtë, ta adhuroni vetëm Allahun, dhe mos t'i shoqëroni Atij askënd. Ata s'janë tjetër vetëm të dërguar dhe udhërrëfyes. O popull, unë kam besuar çka thonë ata. E çka më pengon mua të mos adhurojë edhe të mos i përmbahem Atij i cili më ka krijuar, më furnizon...?! E ç'kam unë që të mos jam prej atyre që adhurojnë Allahun Një?! Jo, nuk i shoqëroj Atij askë, ai është i vetmi... O popull, do të ktheheni tek Allahu ditën e kthimit, do të jepni llogari për veprat tuaja dhe do të shpërbleheni dhe: *"Nëse bëni mirë, bëni për vete, e nëse bëni keq, bëni kundër vetës!"*

Çdo e mirë është në dobinë tuaj, dhe çdo e keqe në dëmin tuaj... O popull, apo mendoni se adhurimi i idhujve bën dobi, dhe se idhujt meritojnë adhurim??? Jo, jo, Ai i cili adhurohet dhe duhet adhuroar është i vetmi Allahu xh.sh....

E pse unë të pranoj idhujt për zot?! Të adhuroj tjetër kë përveç Allahut? Nuk bën, unë do të jam prej të humburve e të shkatërruarve. O popull, unë kam besuar Zotin tim dhe tuajin dhe Zotin e të gjithëve, i vetmi, ngadhnjimtari, i urti.

E ata (njerëzit) ishin popull mendjelehtë, kokëfortë që iu përgjigjen: E gjuajtën me gurë derisa e përgjakën, por ai nuk pushoi, as dhembja e madhe nuk ia këputi dëshirën e flakët për shpëtimin e popullit të vet që t'i udhëzojë në rrugë të drejtë dhe me atë zë të mekur, me fjalët që buronin nga loçka e zemrës të shoqëruar me dhembje u lut e tha; O zot, udhëzoje popullin tim, ata nuk dinë.

Por, atyre nuk u mjaftoi vetëm me kaq, e ngrehën zvarrë, ia shumfishuan të rrahurat derisa ai ndërroi jetë. U ngrit shpirti i pastër në vendin e merituar, pranoi kënaqësinë dhe shpërblimin e Allahut, e takoi Atë të kënaqur, e atij iu tha: *"Hyr në xhennet!"*, hyri në të i begatuar, kaluan vështirësitë dhe brengat e kësaj bote... I pa i dashuri të mirat e tija, mori shpërblimin, gjeti vendin e tij tek Allahu xh.sh. dhe tha: *"Ah sikur ta dinte populli im!"*, se çka do të ngjet me ta Shpetova prej atij populli, ngase besova Allahun xh.sh. dhe të dërguarit e Tij. Dhe kështu veproi njeriu i Jasinit, i gjallë e i vdekur që të shpëtojë popullin e tij, ta udhëzojë në rrugë të drejtë dhe që të jetë prej banoreve të xhennetit, por nuk ia ariti... E, Allahu xh.sh. i dha shpërblimin atij populli, dënimin në këtë botë, përveç dënimin në botën tjetër: *"Pas tij Ne nuk zbritëm ndonjë ushtri nga qielli kundër popullit të tij, e as që ishte vendimi ynë të zbrisim tjetër, përveç një britmë të tmerrshme, kur qe ata të vdekur"*. (Jasin, 28).

Le të mjaftojë shembulli i njerut të Jasinit¹ për ata që logjikojnë e thonë: "kërkojmë faljen tënde o Zot".

Dhe le të shërbejë populli i njeriut të Jasinit si përvojë për ata që nuk mendojnë (mendjelehtët). E ne nuk u themi atyre gjë tjetër vetëm të kenë kujdes, ruajuni se: *"Kthimi i të gjithë juve është te Allahu dhe Ai ju njofton për atë që vepruat!"*

Osman Mehmeti kl. IV

1. Quket njeriu i Jasinit ngase shembulli i tij nuk përmendet askund tjetër përveç se në kaptinën Jasin.

PËRGOJIMI

Për përgojimin shpesh herë flitet e shkruhet. Zakonisht përmenden ajetet për atë se përgojimi është i njëjtë me ngrënien e mishit të vëllaut të vdekur (El-Huxhurat, 12) apo hadithet siç është ai ku h. Aishja r.a. e ka përgojuar h. Safijen r.a., e Muhammedi a.s. i ka thënë se aq fjalë të rëndë ke folur, sa që deti do të turbullohej po të përzihej me të. (transmetojnë: Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, - hadith hasen sahih). Përmendet edhe definicioni i përgojimit (gibetit): të flitet për dikend në mungesë të tij, atë çka ai nuk do të dëshironte të flitet për te. Megjithatë, edhe krahas gjithë kësaj, përgojimi rrallë herë saktësisht përkufizohet, sepse ky definicion nuk është i plotë. Me fjalë tjera, kemi situata kur përgojimi është i lejuar, e ndonjëherë madje edhe i nevojshëm. Këto situata duhet t'i njohim, për shkak që saktësisht të dimë se çka bën pjesë e çka jo në përgojim - këtë mëkat të madh, e kështu që të mund të kujdesemi që mos të bëjmë.

Këtë shumë mirë na e kanë përkufizuar dijetarët e vjetër siç janë Gazaliu, Neveviu etj. Neveviu i njohur për këtë problematikë flet në veprën e tij: "Rijadus-salihin" në kapitullin e 256. Menjëherë në fillim të tij ai thotë këtë: "Dije se përgojimi është i lejuar për ndonjë qëllim të arsyeshëm të sheriatit, deri te e cila nuk mund të arrihet ndryshe përveç se me përgojim". Vetëm me këtë fjali na bëhet shumë më e qartë se kur është përgojimi i lejuar, por për shkak të shpjegimit më të plotë ai (neveviu) i shënon gjashtë (6) situata kur kjo ndodh, kështu që tani do t'i cekim ato:

1) Kur dikujt i është bërë e padrejtë. Në këtë rast i është e lejuar këtij personi që të paraqet rastin e vet individit apo organit kompetent, që ta mbrojë atë. Për këtë kemi bazë në këtë hadith: "Atij të cilit i është ndaluar ndonjë e drejtë, këtë mund ta thotë". (Muttefekun alejh).

2) Kur dikend dëshirojmë ta largojmë nga të bërit e ndonjë veprë të keqe. P.sh. nëse e dimë dikend se bën diç të keqe, guxojmë të përgojojmë para prindërve të tij apo para dikuj tjetër i cili do të mund të ndikonte në këtë që të ndalet nga ajo vepër. Kjo është e arsyeshme vetëm në rast nëse me këtë dëshirojmë diçka të ndreqim, se përndryshe është haram (e ndaluar). Vërtetimin për këtë rast mund ta gjejmë në hadithin e ardhshëm: Transmetohet nga h. Ajsheja r.a. se ka thënë: "Hinda, bashkëshortja e Ebu sufjanit me një rast i ka thënë të Dërguarit të Zotit: "Ebu Sufjani është koprac (dorështërnguar), e nuk na jep mjaft mua dhe fëmijut, kështu që mua më duhet të marrë nga ai e që ai këtë mos ta dijë". Muhammedi a.s. i tha: "merr aq sa të mjafton ty dhe fëmijut, pa e tepruar". (Muttefekun alejh).

3) Kur dikush dëshiron që t'i skjarohet qëndrimi i sheriatit. P.sh. njeriu mund të vijë tek ai i cili njeh ligjet e sheriatit

e t'i thotë: Të padrejtën ma ka bërë baba, vëllau apo dikush tjetër, e a ka ai të drejtë për këtë. Është më mirë që në këtë situatë të flitet në veten e tretë: Dikush dikujt i ka bërë këtë e këtë..., pa e precizuar ata persona, edhe pse është e lejuar që edhe direkt të thuhet për këndë është fjala. Edhe këtë mund ta vërtetojmë nga hadithi i mëparshëm.

4) Paralajmërimi besimtarëve në ndonjë të keqe që do të mund t'iu ndodhë. Kjo është e lejuar, e madje edhe obligim sipas mendimit unanimit të mbarë ummetit. Këto janë rastet kur dikush interesohet për ndonjë person për qëllim të martesës, apo për shkak të bashkimit me të në ndonjë punë apo për shkak të ardhjes në fqinjësi të atij personi. Ai i cili do të jetë i pyetur në këto raste për dikend tjetër, është i obliguar që ta thotë të vërtetën për te, edhe madje nëse ka të bëjë për gjëra të këqija sepse kjo është në interes të hajrit. Ka shumë raste të cilat bëjnë pjesë në këtë pikë e ja edhe dy: nëse shohim dikend se kërkon ndonjë këshillë apo dëshiron të mësoj diçka nga ndonjë person, e atë person ne e njohim si të keq, e kemi obligim që ta njoftojmë për këtë. Po ashtu, nëse ndokush punon, në ndonjë punë për të cilën nuk është i aftë, duhet që ta njoftojmë personin përgjegjës, që të mos vijë gjer të dëmi. Kjo mund të vërtetohet me shembullin e ardhshëm: Fatimja b. Kajs r.a. ka ardhur tek Muhammedi a.s. dhe i ka thënë: "Ebu-l-Xhehemi dhe Muavija dëshirojnë të më fejojnë mua" e Muhammedi a.s. i është përgjegur: "Muaviju është i varfër, kurse Ebu-l-Xhehemi shpesh është i larguar nga shtëpia". (Muslimi).

5) Kur dikush publikisht bën mëkate dhe këtë nuk e fsheh. P.sh. nëse dikush publikisht pi alkool, grabit pasurinë e huaj e ngjashëm. këtë është e lejuar ta themi, kurse është haram ta themi atë çka ai person e bën fshehtas (përveç nëse ajo punë nuk ka të bëjë me njërin nga këto gjashtë pika). Për këtë kemi shembull në hadithin e ardhshëm: H. Ajsheja r.a. transmeton se një njeri ka kërkuar leje që të hyjë tek i Dërguari i zotit e ai ka thënë: "I lejoni të hyjë, edhe pse ai është njeri i keq". (Muttefekun alejh) Buhariu këtë hadith e merr për argument se është e lejuar t'i përgojojmë ata të cilët bëjnë çrregullira, ngatresat. Është interesant që këtu të përmendet rasti i këtij njeriu, që të mund të shihet se sa ka pasur të drejtë Muhammedi a.s.: Neveviu në veprën "Sahihu Muslimin bi sherhin - Nevevi" duke komentuar këtë hadith e përmend emrin e atij njeriu (Ujejne b. Hasn). Pastaj, tregon se ky njeri atëherë vetëm sa për sy e faqe paska pranuar islam, e gjatë kohës së hilafetit të Ebu Bekrit ka dalë nga feja, dhe si i tillë edhe burgoset. Pra, Muhammedi a.s. me këtë rast ka dëshiruar që të tjerët t'i paralajmërojë që të kujdesen ngatresat të tij.

6) Ta themi llagapin apo mungesën në trup nëse dëshirojmë që dikënd ta përcaktojmë. P.sh. kur të flasim për dikënd, e ai të cilit i flasim nuk mund t'i kujtohet për kend është fjala, atëherë mundemi t'ia themi: ai që nuk ka dorë, që nuk ka sy apo t'ia përmendim llagapin e tij. Kjo është e lejuar, edhe pse prap më mirë është nëse mundemi pa këtë. Për këtë kemi shembull në hadithin të cilin shënon Buhariu, në të cilin thuhet se me një rast Muhammedi a.s. nga harresa ka falë vetëm dy rekate të farzit të drekës, e ashabët kanë pyetur se përse ndodhi kjo. Disa menduan se i ka ardhur urdhëri të Dërguarit që farzi i drekës të shkurtrohet në dy rekate, e një as'hab i cili ka pasur duart e gjata ka thënë se në këtë rast Muhammedi a.s. nga harresa i ka falur dy rekate. Muhammedi a.s. ka thënë: "Ka të drejtë ai i cili i ka duart e gjata". Nga të gjitha këto situata mund të përfundojmë se përgojimi është i lejuar atëherë kur dëshirojmë që më këtë të bëjmë ndonjë vepër të mirë, pra, kur e kemi qëllimin e

mirë e jo kur këtë e bëjmë për shkak të vet përgojimit. Pra, kjo mund të përmbledhet në hadithin e njohur: "Veprat çmohen sipas qëllimeve". (Muttefekun alejh). D.m.th., nëse dëshirojmë që sa më lehtë të përcaktojmë në ndonjë situatë se a lejohet dikënd ta përgojojmë apo jo, duhet vetëm të nisemi nga qëllimi, e nëse qëllimin e kemi të mirë (si në këto gjashtë raste), atëherë këtë mund ta bëjmë. Mirëpo, nëse megjithatë ndodh që dikënd pa shkak të arsyeshëm ta përgojojmë, duhet që për këtë menjëherë të pendohemi dhe ta themi këtë lutje: "ALLAHUMMAGFIR LENA VE LEHU" (O Zot, me fal mua dhe atë që e përgojova). (Hadithin e transmeton Ibnu Ebu Dunja).

E kur ta takojmë këtë person që përgojuam, atëherë nga ai duhet të kërkojmë hallall (falje).

Enis Rama IVa

PA KOMENT !!!

ME PLOT EMOCIONE

SHKRIME VE UANISI,

MOS PËRGOJONI SHOKË:

THOTË VETENISI.

Artani shton

me plot krenari:

respektone Kur'anin

n'robëri e liri.

Hadithet janë shumë të nevojshme,

shkrijnë çdo pengesë,

nxiton z. Alberti

pa fare përtesë.

Për t'i kuptuar versetet

thotë Muslimi iu duhet shëndet,

andaj mos pini duhan se ju lë të shkretë.

Pastërtia është primare,

shton pa ngurresë Bashkimi,

pa të s'falet dot,

vërteton Alaudini.

Agjëroni, agjëroni,

tërheq vërejtjen Ferati

këtë mund ta bëjë

edhe çorri e sakati.

Të gjithë e besojnë Zotin,

s'e beson vetëm ndonjë tup,

kjo është e vërteta

shkurt Jakup

Zoti betohet në kohën

duke treguar vlerën e saj,

në të është Lulëzimi e përparimi
koprracëve do t'iu hakmerret pa
ndonjë faj.

Çdo shitëpi ka shtylla

e shtyllë e çdo populli është rinia,
porosit me plot bindje Imeri

"Ruane atë fitohet liria".

Morali, edukata e arsimit,

janë pjesë të një trangu,

pa to s'kalitet shpirti,

këtë e merr vesh edhe bufi

Kështu mendon Adnani,

po ç'na thotë Osmani;

jepni pa nda zekat,

aty vërtetohet imani.

Selamun alejkum,

të dashur kolegë,

konstaton Ramuzi:

"ky është humanitet".

Shpejtoni n'vëpra të mira,

tërthorazi na drejtohet Irfani,

a e dini se...

shumë afër është tufani. "ose" (për
dekë po bjen tupani).

Udhëzimet hyjnore

njeriut i janë dedikuar,

të tregohemi ndaj tyre besnikë

nëse dëshirojmë për të shpëtuar.

Besnikëria është traditë e këtij
populli,

besa e shqiptarit e shpon çelikut,

besa besë e fjala fjalë,

numri i ardhshëm së shpejti do të
dalë.

Besnik Berisha

DEVOTSHMËRIA E XHUREJXHIT (hadith)

Xhurejxhi ka qenë njeri shumë i devotshëm, kështuqë për vete ndërtoi një faltore të veçantë, në të cilën u tërhoq dhe gjithnjë e adhuronte Allahun. Njëherë vjen nëna e tij në faltore dhe e thërret: "Xhurejxh!" ai tha: "O Zot, nëna ime dhe ibadeti im!" - dhe vazhdon të lutet. Tjetër ditë sërish vjen nëna e tij dhe thotë: "Xhurejxh!" ai i përgjigjet: "O Zot, nëna ime dhe ibadeti im" - dhe vazhdon ibadetin e tij. Sërish kur agoi mëngjezi, erdhi nëna dhe e thirri Xhurejxhin, e ai sërish tha: "O Zot, nëna ime dhe ibadeti im!"

Në atë i thotë nëna: "O Zot, mos e lë të vdes, e të mos shikon në fytyrën e lavirës".

Në mes të izraelitëve në atë kohë flitej në atë vend për Xhurejxhin dhe devotshmërinë e tij. Atëherë në atë qytet jetonte një lavire e bukur, e cila ishte shembull për bukuri. Ajo iu thotë qytetarëve: "nëse doni unë Xhurejxhin do ta sprovojë? I Dërguari i Zotit tha: "Dhe ajo tentonte që ta bëjë për vete apo ta mashtrojë, mirëpo ai as që është kthyer kah ajo". Lavirja atëherë shikon te një bari dhe me të bën marrëdhënie intime, ku edhe mbetet shtatëzënë. Kur u lind fëmija ajo deklaroi se është i Xhurejxhit. Ky lajm u përhap në tërë qytetin. Shumica e qytetarëve erdhën para faltorës së Xhurejxhit, e nxorën atë jashtë dhe e rrëzuan faltoren, e pastaj vazhduan që ta mundojnë. Xhurejxhi duke mos ditur se për çka po bëhet, pyeti: "Çka ndodhi?" Populli bërtiti "ti ke bërë zina (aktin intim) me këtë dhe këtë grua dhe ajo ka lindur". "Ku është fëmija"? - pyeti Xhurejxhi. Ia sollën fëmijun, kurse Xhurejxhi i luti njerëzit që ta lënë të qetë, përderisa t'i lutet Zotit.

Kur e kreu adhurimin (ibadetin), i ra me gisht fëmijut në stomak dhe tha: "Djalosh, kush është babai yt?" "Ai bariu!" - u përgjigj fëmija. Pas kësaj grumbulli i njëzve nxituan te Xhurejxhi duke e përqaftuar dhe puthur. I ofruan që t'ia ndërtojnë një faltore të re prej ari, e ai u tha atyre: "Jo, ndërtonë prej balte sikurse ka qenë më herët". Ashtu edhe vepruan!

Njëherë sërish një fëmijë e ushqente një nënë dhe në atë vjen një njeri me rroba të zotërisë duke kalëruar me një kali të bukur. Nëna thirri: "O Zot, bën që fëmija im të jetë sikurse ky!" në atë fëmija e lëshon gjirin, kthehet kah kalorësi dhe tha: "O Zot, mos më bën që të jem sikurse ai!" - e pastaj vazhdon me të ushqyerit.

Duke ecur më tutje, nëna vëren se një grup (njerëzish) mësyen në një grua duke e rrahur dhe bërtitur: "lavire! Plackitëse!". Gruaja bërtiti: "Më njafton Allahu dhe Ai më është dëshmitar (që jam e pastër). Nëna e fëmijës tha:

"O, Zot mos lejo që djali im të bëhet kështu!". Fëmija në ato fjalë thotë: "O Zot, më bën që të jem sikurse ajo grua!".

Fëmija pastaj i tregoi nënës se ai kalorësi ka qenë-mizor, kurse gruaja të cilën e kanë quajtur lavire dhe vjedhëse, nuk ka qenë as lavire as vjedhëse.

zgjedhi:

Albert Haziri kl.IVa.

marrë nga "Rijadus-Salihin".

THËNIE TË PEJGAMBERIT A.S. PËR DITURINË

- Nuk vdes kush mëson!
- Jam dërguar që t'i mësoj të tjerët!
- Mos më bekoftë (mëshiroftë) Allahu ditën që nuk mësoj diçka të re!
- O Zoti im, më ruaj nga dituria që nuk sjell dobi!
- Kush vdes duke kërkuar dituri, kurse dëshira e tij ka qenë që të sjellë përparim jetës dhe botës islame, në mes tij dhe të dërguarve të Zotit në xhennet ndryshimi do të jetë vetëm për një shkallë!
- Një orë studim është më mirë se një natë ibadet!
- Dijetarët dhe luftëtarët në rrugë të Allahut janë më së afërmi pejgamberëve të Allahut xh.sh.!

- Më së ulti (poshti) për nga rangu në ditën e gjykimit do të jetë studiuesi nga dituria e të cilit nuk ka kurrfarë dobie!

- Kush do të pyet për diçka çka ai e di, e e fsheh atë dituri, në ditën e gjykimit do të jetë i frenuar me fre prej zjarri!

- Fatkeqësia e diturisë është harresa, kurse ajo që e shkatërron diturinë është të dhënit e saj atij që nuk i është besnik!

- Mos më pyetni për të keq, më pyetni vetëm për të mirën! (këtë e përsëriti i dërguari i Allahut tri herë e pastaj shtoi:) Mbani mend! Të këqijat e së keqës janë më të vërtetë dijetarët e këqinj, kurse të mirët e së mirës janë më të vërtetë dijetarët e mirë!

PËRKTHEU: nga boshujakishtja: Albert Haziri

GUSLI, PASTRIMI ISLAM

ISLAMI i kushton rëndësi të madhe pastërtisë. E këtë e vërtetojmë ndër të tjera edhe me një hadith të Pejgamberit a.s. ku thotë se çdo musliman e muslimane e ka obligim të pastrohet të premtëve.

Megjithatë ekzistojnë edhe disa situata kur muslimani e ka obligim të pastrohet d.m.th. e ka farz.

Kur'an i përmend termin "xhunub" që nënkupton gjendjen e njeriut pas ejakulimit të spermës, pas marrëdhënieve intime apo edhe në ëndërr. Mandej termi "hajd" - menstruacionet mujore te femrat, dhe "nifas" që konsiderohen 40 ditë te femra pas lindjes. Situatat e përmendura janë ato që më së shpeshi e ka obligim muslimani-ja të marrë gusul (pastrohet).

E dimë se pastrohet edhe trupi i muslimanit të vdekur por edhe personi i cili pranon islamit.

Allahu xh.sh. në kapitlen el-Maide: 6 thotë .

"E nëse jeni të papastër, atëherë pastrohuni... Allahu nuk dëshiron t'ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë (prej mëkateve), t'ju plotësojë të mirën e tij ndaj jush e që t'i falënderoheni".

Muslimanët guslin (pastrimin) duhet ta kuptojnë si urdhër të Allahut. Po të mos ishte kjo, ne me të vërtetë nuk do të pastroheshim për shkak të pastërtisë pas çdo ejakulimi.

Njeriu ka një ndjenjë të çuditshme, shpeshherë edhe traumatike ndaj seksit. Kur'an i përmend popuj të cilët nga të tejkaluarit e moralit janë dënuar kolektivisht me dënime të ndryshme. Prandaj duhet të dimë se çdo largim nga rregullat të cilat i vuri Allahu për moralin, është dekadencë e vetvetes".

Kur'an i dhe hadithi kërkojnë largim nga çdo vulgarizim por jo edhe ajo të jetë tabu. Për ata muslimanët duhet të jenë të udhëzuar në aspekte fetare, shëndetësore, dhe psikike për pastrimin.

E kur thotë Allahu se me rregullat të cilat i vuri për pastërti nuk dëshiron të na vështirësoj, por dëshiron të jemi të pastër, theksoj se rregullat e Tij i ndiejmë si begati, e këtë e vërejmë pas pastrimi.

Me të vërtetë kur jemi në gjendje të papastërt-xhunub, e ndiejmë veten të lodhur, të molisur dhe të çrregulluar, e pas pastrimi të pushuar të disponuar. Pejgamberi a.s. thotë :

Falënderimi i qoftë Allahut i cili na i ka dhënë rregullat islame.

SI MIRRET GUSLI

Së pari themi eudhu-besmelen dhe veprojmë siç ka vepruar Pejgamberi a.s.:

1. shpërlajmë gojën (mirë dhe sa më thell).
2. E shpërlajmë hundën (mirë).
3. E pastrojmë tërë trupin sa të mos mbetet asnjë vend në trup pa u lagur.

Pra këto tri kushte janë të domosdoshme për t'u pastruar.

Për të parë rëndësinë e guslit mund ta përmendim edhe hadithin e Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton Abdullah ibni Abbasi ku thotë: Tri grupe të njerëzve melaiket nuk iu afrohen ndër ta është edhe personi i cili është xhunub (përveç nëse merr abdest). Sipas këtij hadithi nënkuptojmë se nuk guxojmë të flegmë natën pas marrëdhënieve intime pa marrë abdest, nëse mundemi të pastrohemi në mëngjes para kalimit të namazit të sabahut.

Gusli - PASTRIMI DHE SHËNDETI

Të pastruarit pas marrëdhënieve intime, ejakulimit në ëndërr, hajdit, nifasit, ndikon dobishëm në sistemin nervor, largon ndytësinë dhe mbron shëndetin.

Organizmi para orgazmës ka qenë emocionalisht dhe fizikisht i ngarkuar (i shqetësuar). Gjatë orgazmës jo që vjen deri te kënaqësia seksuale porse rritet pulsi, enët e gjakut zgjerohen, cirkulacioni shpejtësohet që manifestohet me hargjimin e energjisë, vjen deri te djersitja, lirimi i nxehtësisë. Djersitjen e kap tërë organizmi, ajo del nga çdo vend në trup. Ai me vete sjell produkte metabolike dhe kripë të kuzhinës.

Të shpërlarit e hundës dhe gojës është me rëndësi për arsye se gjatë orgazmës vjen deri te rritja e metabolizmit të gjëndrrat pështymorë.

Tani e kemi të qartë për rëndësinë e guslit, për pastrimin e trupit "duke mos lënë asnjë vend në trup pa u larë".

Nëse nuk e bëjmë pastrimin islam (guslin), me përjashtim nëse nuk kemi mundësi, atëherë na mbyllen të gjitha dyert e mirësisë, kurse na prijnë rrugët e cytjeve të shejtanit, të mashtrimit, të humnerës së çfarëdo lloji dhe njëherit do të na prijnë mendimet e këqija dhe emocionet e prishura.

Për atë mos dilni nga shtëpitë e juaja, mos kapërceni (kaloni) në rrugë të papastër. A mundeni aq të rrezikoni që në rast se ju kaplon vdekja, para melaikëve të vdekjes të jeni të papastër?

Derisa jemi xhunub, ndalohet të falem, të bëjmë tavaf Qaben, të hyjmë në xhami, kurse femrës i ndalohet të agjërojë në kohën e hajdit dhe nifasit.

O Zoti ynë, Ti që e do pastërtinë, bëna neve nga ata të cilët kërkojnë pendim te Ti dhe pastrohen shumë.

Alaudin Abasi IVa

NAMAZI

Njëmend asnjë institucion tjetër nuk është përsëritur dhe nuk është theksuar dhe urdhëruar aq shumë sa namazi. Prej 67 herëve sa është përmendur në Kur'an, 25 herë përmendet në formë të imperativit (emrit), në suren Bekare namazi përmendet nëntë herë në ajetet 3, 43, 45, 83, 110, 153, 177 etj.

Ta studiosh këtë normë nëpërmjet të Kur'anit do të thotë ta studiosh njeriun dhe historinë e tij. Studimi i natyrës dhe ligjshmërive të saja, rrjedhat e posaçme, do të ishte gabim i madh që kjo normë të përcillet prej shpalljes së Kur'anit e të lihet pas dorë periudha e gjatë që i ka paraprirë. Frymën e namazit e ndjejmë në pendimin e sinqertë të njeriut të parë në tokë, Ademit a.s. (el-Bekare, 37), në duan e vet të njohur, në vendin më të shenjtë të globit tokësor, te Bejtullahi, Ibrahim a.s. e lut All-llahun xh.sh. për shpëtim dhe fat të gjeneratave të ardhme. Fat i tyre është kushtëzuar me kryerjen e namazit (Ibrahim, 40). E njëjtë është përmbajtja e duas të cilën e bëri Ibrahim me të birin Ismailin në momentin e rindërtimit të Bejtullahut (el-Bekare 127).

Normën e namazit e shohim edhe në shëriatin e pasardhësve të tij, Is'hakut a.s. dhe Jakubit a.s. (el-Enbija, 73). Shuajbi a.s. iu ishte ekspozuar sulmeve të mëdha nga bashkëvendësit e vet, të cilëve iu pengonte namazi i tij nëpërmjet të cilit madhërohet dhe lavdërohet Ai që nuk ishte në besimin e etërve të tyre (Hud, 87). Në testamentin e Llukmanit të cilin ia la birin të vet, namazi është palca e këtij testamenti (Llukman, 17). Në luginën e bekuar Tuva, Musai a.s. dëgjon principet themelore të shpalljes: "Unë jam, njëmend, All-llahu, pos meje nuk ka zot tjetër; për këtë falenderoni vetëm mua dhe kryejë namazin - që të jem gjithmonë ndërmend" (Taha, 14). Në kohën e terrorit të madh dhe gjenocidit që bëhej mbi isrealitët në Egjipt, Musai a.s. urdhërohet që, armikut të këllillë të fuqishëm dhe brutal t'i kundërvihet me fe, me armën më efikase. Norma themelore e fesë së tij ishte namazi (Janus, 87). Më në fund Isai a.s. qysh në djep e paralajmëron namazin si obligim jetësor der në vdekje (Merjem, 31).

Këtë histori të namazit të cilin na e parashtrohet Kur'ani, ka rëndësi shumë të madhe, sepse na udhëzon në njësinë e shpalljes dhe normave. Namazi pra, nuk është vetëm normë themelore e islamit, por i shpalljes në tërësi.

Është shumë me rëndësi të ceket, se namazi është institucioni i parë i jetësuar në islam (në vitin e tretë sipas hixhrit), si edhe të gjitha ibadetet janë bërë obligim në tokë përveç namazit.

Këtë obligim Muhamedi a.s. e pranoi në shpirtin dhe zemrën e vetë në qiell me rastin e miraxhit të vet të madh. Sikur ndihej nevoja që Pejgamberi të jetë sa më afër burimit për të pranuar këtë urdhëresë. Me këtë iu bë nderë atij e njerëzimit nëpërmjet të normës së namazit iu dha mëshira e madhe dhe begatia.

Duke mos dashur që të largohem nga tema, deri këtu i bëmë një vështrim historiat të namazit me Kur'an. Tash është radha që ta theksojmë esencën dhe rolin e namazit në jetën e njeriut dhe qëllimet që arrihen me të. Më së pari për shkak të faktit, nëse njeriu me namaz nuk i arrin qëllimet e caktuara, atëherë ky nuk është ai namaz të cilin e ka bërë obligim dhe e ka urdhëruar Kur'ani. Duhet pranuar se pamja e namazit nëpërmjet të praktikës së një numri të madh të muslimanëve, është plotësisht në kundërshtim me obligimin e namazit nga ana e Kur'anit. Mu për këtë shpeshherë

formohet një pasqyrë e gabuar ndaj normës themelore të islamit. Pasqyrimet e këtilla të deformuara mund të shërohen vetëm me Kur'an.

Shikuar nga aspekti islam, njeriu është krijuar për t'i bërë ibadet All-llahut xh.sh. (edh-dherijat, 56). Qëllimi i namazit është, që njeriu ta përkujtojë Krijuesin e vet, vendin dhe rolin e vet të cilin ai ia ka caktuar. Njeriu gjithmonë është në ibadet, kur punon në arë ose në fabrikë, kur komunikon me njerëzit dhe rrethin. Islami të gjitha këto i konsideron si ibadete, nëse njeriu të gjitha këto aktivitete të veta i drejton kah e mira gjegjësisht, ia nënshtron qëllimeve në të cilat e ka udhëzuar All-llahu xh.sh. Mirëpo namazi është forma më specifike, më e përsosur e ibadetit. Këto nuk janë vetëm fjalët e shqiptuara me gjuhë a lëvizje të trupit pa praninë e shpirtit dhe vetëdijes. Nuk ka namaz të duhur pa angazhimin e plotë të vetëdijes. Pa këtë, as që ka njeri të shëndoshë e as shoqëri të shëndoshë. Në ajetin e 43 të sures en-Nisa, ndalohet hyrja në namaz në gjendje të dehur: "O besimtarë, mos e kryeni kursesi namazin të dehur, deri sa të mos e dini se çka flitni".

Vetëm vetëdija e shëndoshë mund të vijë në kontakt me krijuesin dhe botën, vetëm vetëdija e pastërt dhe e shëndoshë mund ta shprehë të vërtetën mbi krijuesin dhe botën. Nuk e sollëm pa arsye këtë tekst të Kur'anit, me të cilin paralajmërohet ndalimi i pijeve alkoolike në islam. Kjo na dëton, në mes tjerash, fizikisht është e lidhur edhe me normën e namazit. Roli themelor i namazit është që "të largoj nga pasionet dhe nga çdo gjë e keqe" (el-Ankebut, 45).

Duke iu falënderuar namazit, pati sukses ndalimi i pijeve alkoolike menjëherë në fillim të islamit. Ende mund të pohojmë, se ky ishte prohibicioni i vetëm i suksesshëm i kësaj të keqe të rrezikshme njerëzore në histori. Kishte shumë orvatje në këtë drejtim, por të gjitha përfunduan me pa sukses, të gjitha përveç atyre kura'nore. Ta përkujtojmë orvatjen e prohibicionit të pijeve alkoolike në SHBA vitin 1919. Njëri prej shteteve më të fuqishme të botës së sotme, i përdori të gjitha mjetet që i kishte në disponim me qëllim që të ketë sukses kjo ndërmarrje. Ndajësia është publikuar me të gjitha mjetet e informimit publik, janë burgosur 532.330 persona, janë varur 300 persona, është konfiskuar pasuria në vlerë prej 400 milion dollarë, të ardhurat nga dënimet arritën afër 16 milion dollarë... Mirëpo, ky ligj mbeti në fuqi vetëm 14 vjet, u anulua në vitin 1933. Pas kësaj, jo vetëm se iu kthyen njerëzit konsumimit të mëparshëm të pijeve alkoolike, por situata u keqsua edhe më shumë dhe kështu shoqëria amerikane e pa përmbajtur marshoj në "epokën e drogës".

Është normale që të parashtrrohet pyetja e suksesit të prohibicionit islam në Medinë i cili i parapriu atij amerikan para 14 shekujve. Përveç dallimit të madh në kohë, këtu ka dallime të mëdha edhe në shkallën e kulturës, arsimin dhe vetëdijes. Sipas mendimit tim, fshehtësia e suksesit të këtij prohibicioni të vetëm të alkoolit në historinë e njerëzimit, fshihet në atë që ajo është kur'anore, hyjnore. Kryerja e namazit pesë herë në 24 orë, e përjashton edhe konsumimin më të pakët të alkoolit. Më parë tham se namazi është një gjendje, ku njeriu duhet të jetë i koncentruar sa më shumë që është e mundur, që të jetë plotësisht i vetëdijshëm për atë çka e shqipton. Kur është fjala për namazin, ashtu siç e

sqaron Kur'ani, duhet të theksojmë, se njeriu mund të dehet edhe me diç tjetër përveç alkoolit. Sa ka të atillë të cilët nuk e dinë se çka kanë thënë në namaz, e nuk e kanë shijuar asnjë pikë të alkoolit. I dehur me padituri, me pakujdes ndaj namazit, me dashurinë ndaj pasurisë, ose dunjallekut. Kur'ani i kërcnohet me denim të ashpër, atë të cilin nuk është prezent me vetëdije në namaz (el-Maun, 5), atyre të cilët me vështirësi dhe pertaci hyjnë në namaz, atyre që e kryejnë për hirë që të bien në sy të tjerëve se janë në namaz (en-Nisa, 142).

Namazi është lidhja me Krijuesin, botën dhe jetën. Kjo lidhje patjetër duhet të jetë e përhershme. Kjo posaçërisht është theksuar: "Besimtarëve namazi iu është bërë obligim në kohë të caktuar" (en-Nisa, 103). Kjo lidhje Kur'anore e namazit me kohën, i ka shtyrë një pjesë të ulemave që të pohojnë se, namazet e lëshuara nuk mund të kompenzohen. Ata të cilët e lejojnë zëvendësimin-kompenzimin e namazit të lëshuar, njëzërit pajtohen në mendimin se kjo nuk është mirë (kerahe).

Namazi është rregullatori i zemrës së njeriut. Njeriu e stolisin vyrtet dhe natyra e melekëve, por nuk është imun as nga epshet shtazarakë dhe shprehitë e këqia. Në të gjithmonë zhvillohet beteja e madhe dhe e përhershme në mes të këtyre dy shprehive. Qëllimi i jetës njerëzore shkon kah ajo që në njeriun zë triumfon ajo që është humane dhe madhështore. Megjithatë, toka e tërheq fuqishëm, kështuqë egziston rreziku që në të, të fitojë ajo që është e ulët, shtazarakë, mëkatore dhe epshore. Nga pikëpamja islame, nuk është çudi që gabon njeriu, secili njeri është i gabushëm. E çuditshme është ajo nëse, ai nuk i përmirëson gabimet e veta, nëse bjen në nivelin shtazarak, bile edhe nën këtë nivel (el-A'raf, 179). Në këtë edhe është funksioni i qëndrueshmërisë së namazit, ai nuk lejon që në njeriun të dominojnë fuqitë destruktive.

Me namaz akumulohet ajo pjesë e njeriut e cila nuk mund të kënaqet plotësisht me çfarëdo shkence qoftë me filozofi ose art. Ky është përjetim kur ai ngritet prej tokës në qiell, këtu i hapen dyert, këtu ai bisedon me Krijuesin e vet, pa përkthyes dhe ndihmës, ai e sheh veten këtu dhe e ndien në natyrën dhe funksionin e vërtetë.

Namazi është e vetinja normë në islam i cili parashihet në të gjitha rrethanat dhe situatat. Përpikërisht është rregulluar mënyra e kryerjes së tij kur njeriu është i shëndoshë ose i sëmurë, në paqë dhe në luftë.

Udhëtarit (Mysafirrit) i lejohet që ta shkurtojë namazin. I sëmurari mund ta kryejë namazin pa kijan, ruku dhe sexhde, në rastin e sëmurjes totale edhe me shenja.

Një kaptinë të posaçme Kur'ani ia kushton kryerjes së namazit në luftë. Namazit të këtille i jepet rol dhe dimension i posaçëm. Mendojmë se këtu është më rëndësi të theksohen dy momente. E para, gjendja e luftës dhe e perleshjeve nuk do të thotë anulim i namazit. Namazi është arma më e fortë si në paqë ashtu edhe në luftë. Ata para të cilëve Muhammedi a.s. është falur si imam në luftë, kanë lënë argumnt të qartë dhe të saktë për këtë gjë. E dyta, kryerja e namazit gjatë luftës përcillet me të gjitha masat dhe preventivat e mundshme ku bën pjesë edhe falja e namazit në grupe, mbajtjen e rojeve, kryerja e namazit me armë të ngjeshura etj. (en-Nisa, 3) Natyrisht, një disiplinë dhe vendosshmëri e këtille në kryerjen e namazit, për shumë njerëz ishte dhe mbetet e pa pranueshme. Praktikimi i namazit në rrethana të këtilla shpeshherë është prurë në lidhje me mospasësitë. Edhe në këtë rast ne duhet t'i besojmë vetëm fakteteve dhe historisë, e ato na dëshmojnë se, muslimanët kanë stagnue prej atij momenti kur ia kanë kthye shpinën kësaj norme.

Nëse mendojmë pak mbi normat e namazit në luftë dhe sëmundje, atëhere ideja mbi mospranimin e kompenzimit të namazeve, na bëhet shumë më qartë. Për të ardhur në situatë për t'u lënë patjetër namazi dhe më vonë të kompenzohet, që ky kompenzim të jetë i arsyetuar dhe i pranuar te All-llahu xh.sh. e shohim se për këtë duhet patjetër të ketë arsye të mëdha. Sidoqoftë, nuk janë këto, ato arsyet dhe situatat në të cilat ne sot e kemi bërë shprehje ta lëshojmë dhe ta kompenzojmë namazin! Mënyra bashkëkohore dhe tempoja e jetës gjithsesi imponojnë edhe është-jen ekryerjes së namazit në disa rrethe. Mirëpo, islami ka lënë edhe mundësi për zgjidhjen e dilemave të këtilla, ulemaja me këtë rast nuk janë përgjegjës vetëm për një detyrë të madhe, por edhe para një përgjegjesie të madhe para njeriut dhe All-llahut xh.sh. Më në fund, athua në shumë ka mundur të vërej dhe të arrijë njohuri mbi All-llahun xh.sh. bediuni në shkretirë para 14 shekujve, ose njeriu i sotëm i cili udhëton me automobil, avion ose raketë. A thua është dashur ai të bie në sexhde All-llahut xh.sh. para njeriut të sotshëm? A thua ai i kalëruar në devet e veta, i ndjekur nga shkretira dhe fryma, kishte kushte më të mira për namaz nga udhëtari i shekullit njëzet? A thua nuk jemi të pa përcaktuar kur themi se jetojmë në epokën e të ariturve të mëdha dhe aksioneve dhe a thua kjo nuk është epoka edhe e mëkateve të mëdha?

Nuk ka dyshim se roli themelor i namazit është që të formojë personalitetin të shëndoshë dhe të fuqishëm. Personalitetet i cili do ta kuptonte esencën e jetës njerëzore, i cili nuk do të binte asnjëherë në kapitullim para vështirësive dhe problemeve jetësore. Nuk është vështirë të vërehet se njeriu bashkëkohor lëngon mu nga kjo mungesë. Njerëzit gjithnjë e më shumë janë të mbushur me frikë, shpirtëngushtsi dhe dëshprim, është e qartë, se njeriu duke e humbur kontaktin me Zotin e ka humbur lidhjen dhe me jetën. Më parë tham se, bash namazi është ajo lidhje. Me hyrjen në namaz, me tekbi (All-llahu ekber), njeriu dëshmon dhe beson, se nuk egziston ndonjë problem të cilin, ai me vullnetin dhe ndihmën e All-llahut, nuk do ta përballojë dhe ta zgjedhë. Këtë ndjenjë, të cilën njeriu vetëm namazi mund t'ia ofrojë, ka ndikim të madh në jetën e personalitetit. Dr. Jusuf Kardaviu, në njërin prej veprave të tij, i parashtrohet mendimet e A. Karlijit i cili paraqet rastet të shërimit të pacientëve nga të cilët medicina kishte hequr dorë. Duke sqaruar këtë fenomen, ai thekson se, këta janë të sëmurët të cilët e kryenin namazin, fitonin vullnet dhe energji nga një fuqi e madhe, e pashtershme dhe misterioze.

Namazi është manifestim i fesë, ai i jep tonin ndjenjave, sjelljeve dhe mendimeve të besimtarit, tregon se si duhet jetuar. ai është bazë e edukimit islam; me ndihmën e tij mund të realizohet shumë, pa të asgjë. Kjo është orvatje e shpirtit njerëzor që të shpëtojë nga shkatërrimi, e shpëtimin e ka që të vijë nën hijen e Krijuesit të vet. Nëse nuk ka një kontakt të këtille shpirtëror, atëherë nuk ka as namaz.

Me namaz arrihet qetësia dhe siguria shpirtërore, e kjo prap është pushim më i mirë për trurin dhe sistemin nervor. Tomas Hajslub, duke folur për namazin thotë se: "Ka bindje të thellë në praktikën e tij shumëvjeçare, se qetësia dhe rehatia me asgjë nuk mund të arrihen si me namaz. Asgjë sikurse namazi nuk mund t'i qetësojë nervat e tij".

Nuk ka nevojë posaçërisht të theksohet se sëmundjet shpirtërore janë dukuri të shekullit njëzet. Këto janë sëmundje të rënda, shërimi i të cilave nuk e arrin efektin e dëshiruar. Edhe medicina bashkëkohore në këtë lëmi ofron fare pak shpresë e kuraj. Si metodë më e suksesshme e shërimit të këtyre sëmundjeve, gjer më tani janë treguar relaksionet dhe qetësimet e ndryshme të këtyre

të sëmurëve. Nëse me kujdes i qasemi kësaj metode të shërimit, nuk do ta kemi vështirë që të vërejmë, se kjo është orvatje e krijimit të atmosferës, të cilën njeriut i ofron mu namazi. Islami pra qysh moti ia ka caktuar pasuesve të vet relaksimin shpirtëror dhe fizik.

Rëndësi të posaçme Kur'ani i kushton kryerjes së namazit në xhematë, bile, disa namaze si ai i xhumasë dhe i bajrameve mund të kryhen vetëm kolektivisht. Dihet se Muhammedi a.s. ka rekomanduar që në namazin e bajrameve të prezentojnë sa më shumë xhemat meshkuj e femra. Bile iu lejohet prania edhe e femrave të cilat nuk mund ta kryejnë namazin. Ato do të prezentojnë gjatë mbajtjes së hytbes dhe duas, pasi që nuk mundin ta kryejnë namazin. Për një grua i kan thënë Muhammedi a.s. se nuk mund të vije në xhami sepse nuk ka robra të duhura, e Muhammedi a.s. i tha: "Litelbithiha uhtuah fi xhibabiha!" Le ta mbulojë motra e saj me pelerinën e vet! Shtrohet pyetja, si dhe me çfarë të drejte gati i kemi izoluar gratë nga xhamija, e prezenca e tyre në namazin e xhumasë dhe të bajrameve, sipas disave është mëkat!

Me namaz të përbashkët krijohen marrëdhënie të shëndosha shoqërore; në mes të njerëzve lidhen lidhjet miqsore dhe dashuria. Posaqërisht në këtë pikëpamje rrol të rëndësishëm ka namazi i xhumasë. Duket paradoksale, por është e vërtetë, se njeriu bashkëkohor është mjaft i vetmuar. Nuk mbahet në mend se njeriu ka vuajtur nga vetmia sikurse sot. Në kohët e tashme psikologët orvatën që të bëjnë shërimin kolektiv të njerëzve të vetmuar. Iu mbahen ligjëratat, me të cilat orvaten t'i u ndihmohet të sëmurve që ta tejkojnë problemin e tyre. Ky lloj i shërimit na përkujton hydben e namazit të xhumasë, me një dallim se me hydbe i drejtohem njeriut të shëndoshë, duke iu përmbajtur gjithmonë rregullit se preventiva është më e mirë se sherimi.

Kemi theksuar më parë se namazi në radhë të parë është ibadet shpirtëror (ibadetun ruhijetun) por është i kushtëzuar me pastrimin e robave, trupit dhe vendit ku do të kryhet namazi. Sipas nevojës duhet të kryhet edhe gusli (lamja), e është e obliguar marrja e abdesit. Për xhami, rekomandohen rrobat më të bukura (el-A'raf, 31). Përgatitjes materiale për namaz i jepet rëndësi e madhe (el-Maide, 6), kështu që edhe nëpërmjet të normave të namazit na paraqitet koncepti i vërtetë i islamit. Ai paraqitet në lidhje të fortë në mes të kaluarës dhe të ardhmës, dunjallakut dhe ahiretit, materiales dhe shpirtërores. Kjo lidhje është prezente në të gjitha normat islame. Abdesi nuk është vetëm pastrim material, sepse musaliu e ndien edhe efektin shpirtëror të këtij riti të përgatitjes për namaz. Larja e pjesëve të caktuara të trupit, pesë herë në ditë, i ka efektet e veta në shpirtin e njeriut, në relaksimin e muskujve dhe në enët e gjakut. Kështu thotë dituria njerëzore, e ta dëgjojmë edhe fjalën e Pejgamberit: "Idha gadibte ve teveda!" (Kur të hidhërohesh, merr abdest!).

Namazi është bashkangjitje në harmoninë e natyrës dhe kosmosit, në ligjshmëritë që mbretërojnë këtu. Njeriut i mjafton që vetëm t'ia hedhë një shikim natyrës dhe të konkludojë se nuk është vetëm. Është i rrethuar me jetën dhe lëvizjen e të parën gjë që e vëren është, se në tërë këtë mbretëron një harmoni dhe precizitet i përsosur. Kur'ani flet mbi këtë dhe shpjegon se ky është namazi i natyrës, namazi i botërave, i qenjeve të gjalla. Pra nuk është njeriu i vetëm i cili i bjen në sexhde Krijuesit, këtë "e bën çdo gjë që ka në qiellëra dhe tokë" (er-Ra'd, 15). "... yjtë dhe drunjtë i bëjnë sexhde" (er-Rahman, 6), "Edhe murmurima e madhëron dhe e lavdëron Atë, e edhe meleqet nga respekti ndaj tij..." (er-Ra'd, 13). "Nuk egziston asgjë që nuk e madhëron Atë, por ju nuk e kuptoni madhërimin e atij" (el-Isra, 44).

Kur'ani me këto ajete ia hap sytë dhe vetëdijen e njeriut, e ndihmon që ta gjejë vendin dhe rolin e vet në këto hapësira të mëdha të All-llahut, që ta njehë se sa mund të jetë i madh dhe sa mund të jetë i ulët. Njeriu është e vetmja qenie në këto botëra i cili e ka vullnetin e lirë. Njeriut i mbetet të vendosë se çka do të bëjë, se a do ti bie në sexhde All-llahut xh.sh., sikurse yjtë shkelqyes, sikurse dielli, hëna, sikurse zogjtë në lartësitë dhe bukuritë qiellore, sikurse bleta e bubrreci, sikurse babai Ademi a.s., ose ndoshta do ta mohojë cicërimin e zogjeve, shkëlqimin e yjeve dhe shndërritjen e rufesë, kështu që ta tradhtojë Ademin a.s. dhe të shkojë në botën e Iblisit. Pra, njeriut i mbetet që të zgjedhë prej këtyre dy rrugëve. Secilit dhe çdo qenie iu është dhënë vetëm një rrugë, e vetëm njeriut dy. Atë që mund të konkludojmë nga tekstet e cituara të Kur'anit, më parë, është ajo se, namazin e kryejnë të gjitha krijesat e All-llahut përveç, një pjese të gjinisë njerëzore.

Njeriu mund të jetojë edhe pa namaz. Kur'ani tërheq vërejtjen bile edhe parashih ardhjen e gjeneratave, të cilat do ta braktisin namazin: "Këta janë ata pejgamberë të cilët All-llahu i ka mbuluar me mëshirën e vet, pasardhësit e Ademit dhe atyre të cilët i kemi bart me Nuhin dhe pasardhësit e Ibrahimit dhe Israilit, dhe ata të cilët i kemi udhëzuar dhe zgjedhur. Kur iu lexohen ajetet e të Mëshirëshmit, ata binin me fytyrë në tokë dhe qanin. E ata i ndërruan pasardhësit e këqinj, të cilët e lëshuan namazin dhe shkuan pas pasioneve: ata me siguri do të kalojnë keq". (Merjen, 59)

Nuk dëshiroj të hyjë në atë se sa janë prezente këto parashikime të Kur'anit në kohën tonë, por është prezente gjithnjë e më tepër, po lihet pas dore namazi e më shumë po ndiqen pasionet. Për njeriun do të duhej të njaftonte që All-llahu xh.sh. t'ia tërheq vërejtjen në këto dy dukuri dhe rreziqe.

Namazin gjer më tani e kemi trajtuar dhe kundruar nëpërmjet të Kur'anit, mirëpo të orvatemi dhe ta kundrojmë namazin nëpërmjet shtëpijave tona, të cilat Kur'ani i lavdëron, ato dhe ata që jetojnë në to:

"Në shtëpitë të cilat ngritën me dëshirën e Atij dhe në të cilat përmendet emri i Atij, edhe në mëngjes edhe në mbrëmje. Në to janë njerëzit të cilët nuk i pengon shitblerja që ta përmendin All-llahun, ta falin namazin, ta ndajnë zeqatin dhe frikësohen nga dita në të cilën zemrat dhe shiqimet do të shqetësohen" (en-Nur, 36).

Në shtëpitë tona me qindra vjet është bërë sexhde, në mëngjes dhe në mbrëmje, vetmas dhe me xhemat. Kështu është edhe sot, kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Mirëpo, në shumë shtëpi tonat më nuk është kështu. Tani edhe vetëm edhe me xhemat në kohën e namazit, në shtëpitë tona, në vend se të kthehemi kah kibla, kthehemi ka idhujt tanë, kah pasionet tona. Nuk ka dallim në mes të shirkut të shekullit të shtatë dhe shirkut të shekullit njëzet. Detyra e islamit është që të luftojë kundër shirkut në çdo kohë. Namazi pa dyshim është arma më efikase e islamit në këtë luftë, por duhet të ruhet, para se gjithash në familjet dhe në shtëpitë tona. Ajo është qeliza e gjallë në të cilën lindet shkëndija e islamit dhe e namazit dhe ruhet, po gjithashtu edhe shuhet.

Përktheu dhe përshtati nga boshnjakishtja:

R. Spahiu

JU PREZENTOJMË IMAMËT TANË

Lexues të nderuar, në këtë numër të Nurit po ju prezentojmë një veteran të Bashkësisë Islame, imamin shumëvjeçar Bahtir ef. Hoxhën.

U lind në fshatin Majac në vitin 1913 në një familje të pasur fshatare me traditë fetare e kombëtare. Mësimet e para i mori në fshatin Halabak, e më vonë ato i vazhdoi në Lupç.

Qysh si i ri dallohej me devotshmëri dhe përkushtueshmërinë e tij ndaj Allahut xh.sh.


Pas "Çlirimit" Bahtir efendiu dhe të gjithë të tjerët që iu përmbaheshin ligjeve të Allahut xh.sh. ishte therrë në sy të pushtetit totalitarë. I ofruan hoxhës që të bashkëpunojë me pushtet duke e emëruar si mësues apo edhe duke i dhënë ndonjë nëpunësi në organet e pushtetit, por ai refuzoi kategorikisht, dhe qëllimi i tij jetësor ishte përhapja e fjalës së Allahut xh.sh..

Pasiqë nuk mundën ta përfitojnë, filluan me metodat e tyre barbare që ta torturojnë me mjetet e njohura në sistemin e njohur fashist dhe ai totalitar komunist.

Për t'i ikur torturave e maltretimeve Bahtir efendiu u detyrua të shesë tokë e mall e të shpërngulet në Prishtinë, ku vazhdoi aktivitetin e tij fetar e sidomos në mësimin e gjen-eratave të reja.

Në Prishtinë emërohet si muezin në xhaminë e Sulltan Muratit (Xhamia e Madhe) por në kohën e aksionit të heqjes së fereksheve, hoxha prap bie në konflikt me pushtetin, nga i cili prapë torturohet e maltretohet. Në vitet e gjashtëdhjeta shërbeu si imam në xhaminë "Alaudin", aty ku ishte edhe Medreseja e Mesme. Shumë ish nxënës të medresës e mbajnë mend mulla Bahtirin si hoxhë të dashur i cili iu ndihmonte në përvetësimin e mësimëve dhe iu mësonte kaside e ilahi. Pushteti totalitarë nuk ia ndaloi zullumin, kështu që në vitet e shtatëdhjeta M. Bahtiri me familjen e vet shpërngulet për në Turqi. Pas 11 vjetëve kthehet prapë në Prishtinë, ku punësohet si imam në Suzi Xhami. Në këtë xhami mësimet e para fetare i morën shumë prishtinas, ndërtoi mejtepin i cili edhe tani shërben për të njëjtin qëllim.

Edhe vet hoxha nuk di të na tregojë se sa nxënës i ka mësuar sepse për të numrat nuk kishin rëndësi, por kishte rëndësi kryerja e amanetit të Allahut xh.sh.. Sipas një flogarie globale del se hoxha mësoi disa mijëra vijues të mësim-besimit, gjatë karrierës së tij 50 vjeçare. Në kohën kur ishte ndaluar mësim-besimi, hoxha këtë punë e kryente ilegalisht. Mësoi të rinj e të vjetër, i mësoi të gjithë ata që e donin islamin.



Hatme beri edhe plaku 82 vjeçar Rizah Kaçaniku para mulla Bahtirit. M Bahtiri për fe fali edhe pasurinë e vet të patundshme në Majac për ndërtimin e shkollës dhe xhamisë.

Edhe sot në pleqërinë e tij të thellë është aktiv dhe vazhdon mësimin e tillë në xhaminë Buzak në Prishtinë.

Ja pra një shembull për ne të rinjtë se si duhet të jemi këmbëngulës në fenë tonë të drejtë. zoti e shpërbleftë M. Bahtirin si në këtë botë poashtu edhe në ahiret.

Imer Krasniqi kl. IVA

FJALË TË URTA

1. Mos zërë gjarpërin nga bishti, se të zë nga gishti.
2. Dorë e thatë, s'ka uratë.
3. I përtuari, i njeruvari.
4. Kali i huaj të lë në udhë.
5. Liria i ka rrënjët në gjak.
6. Kapidani i mirë në furtunë njihet.
7. Në lushë pa zot, gjithë bota kullot.
8. Shtëpia pa libër, si oda pa penxhere.
9. Ujku nijegull kërkon.
10. Zërë gjarpërin dhe shtypi kokën.
11. Zogu në kafas, këndon për maras.
12. Pas luftës, shumë trima dalin.
13. Djali po s'qafti, e ëma s'i jep gj.
14. Ç'ka barku, e nxjerr bardaku.
15. Frika i ruan vreshtat.

Bashkim Avdiu IIIb

PIRJA E DUHANIT

(Në pikëpamje historike, shkencore, medicinale e fetare)

Në shekullin tonë të tanishëm ndezja e duhanit, cigarja, është bërë pothuajse shprehje e pandarë e jetës së njeriut dhe njerëzit kanë mbetur mjaftë të hutuar mes dy publikimeve plotësisht të kundërta në mes veti. Në të njëjtën kohë dhe mënyrë dëgjoen këshilla prej enteve shëndetësore, prej mjekëve ekspertë dhe revistave tjera shkencore të cilat këshillojnë: "mos konsumoni duhan!". Ndezja e duhanit është shprehje mbytëse, e dëmshme për shëndet dhe shkakton kancerin. Në të kundërtën ndërmarrjet tregtare të duhanit reklamojnë të gjitha llojet e cigareve ashtu që të habisin kur thonë: "janë të këndshme, qetësojnë nervat etj". Zakonisht mes këtyre kundërthëniesve, njeriu mbetet i hutuar... çka do të jetë e saktë dhe e vërtetë rreth kësaj çështjeje... cili është mendimi i mjekëve, biologëve i fesë ndaj duhanit?

- Kush e zbuloi duhanin - ?

Kristofer Kolombo është i pari i cili e zbuloi duhanin. Ai i gjeti hindusët e kuq që e mbillnin dhe ndeznin duhanin.

Për herë të parë Evropa e njohu duhanin në vitin 1559 kur e solli anija franceze në Francë.

Arabët nuk ditën për duhanin as në kohën e injorancës, e as në kohën islame, ai u soll te ata në shekujt e fundit, por shprehja e të ndezurit nuk u përhap ndër ta deri sa hyri okupatori në fillim të shekullit XX. Në vitin 1948 shoqëria e mjekëve për pengimin e përhapjes së kancerit në Amerikë, zbuloi lidhmërinë e kancerit në mushkëri me të pimirin e duhanit.

Të ardhurat e ndërmarrjeve në Amerikë arrijnë 5.000.000. dollarë vetëm për një vit. Përveç që edhe pushteti fiton një sasi prej tatimeve, duke i reklamuar cigaret fitojnë shtatëdhjetë milion dollarë në vit.

Prej kur u përhapën konstatimet mjekësore, ndërmarrjet e duhanit u aktivizuan që të përballojnë sulmin, dhe në vitin 1953 filluan të prodhojnë cigare të gjata me filter, gjeja se arritën t'a pakësojnë ndikimin e nikotinit në baza kimike. Këtu punëtorët e lëmisë medicinale u thelluan në studimin e këtyre ndryshimeve dhe dobive të tyre dhe dolën me këtë konstatim: "Materia e nikotinit në cigare është ajo e cila

shkakton disponim (përdorimin) të duhangjiu, dhe se cigarja e cila pakëson nikotinën me anën e filterit dhe përpunimit kimik e humb shijen e kjo e detyron duhangjiun që të përdorë më shumë cigare deri sa të arrijë të njëjtën sasi të nikotinit.

Hulumtimet medicinale vërtetuan se me nikotinën e duhanit janë të ndërlidhura shumë sëmundje të dëmshme për shëndet.

- Duhani sipas fesë -

Duhani nuk ka qenë i njohur në kohën e Pejgamberit a.s. Megjithatë, lidhur me këtë problem shoqëror ekzistojnë disa rregulla të përgjithshme:

- thotë Pejgamberi a.s.:

"Hallall-e lejuar është ajo çka lejoi Zoti në librin e Tij, haram-e ndaluar është ajo çka e ndaloi Zoti në librin e Tij, e për atë që heshti, ajo është prej asaj që u fali Zoti juve".

- Gjithashtu ka thënë Pejgamberi a.s.:

"Vërtet zoti ju bëri farz disa obligime, mos i leni pa i kryer ato, caktoi kufinj mos i kaloni ato, ndaloi sende mos i zini në asgjë, heshti nga disa sende duke patur mëshirë ndaj jush, e jo që i harroi, pra mos pyetni për to".

Në bazë të kësaj pirja e duhanit nuk është e lejuar për tri shkaqe: sepse i bën dëm shëndetit, shpenzon pasuri pa kurrfarë dobie dhe bëhet shprehje që pengon nga agjërimi dhe ibadetet e ndryshme.

kështu që feja islame nuk e lejon një send i cili i bën dëm njeriut, por islami është fe e cila e mbron njeriun e nuk është ajo që shkatërron, sepse një send i cili i bën dëm shëndetit, shoqërisë, familjes, hargjon pasuri pa nevojë dhe shkatërron vetveten në fenë islame është e ndaluar. Në vend se të blehet një pako cigare më mirë është t'i ipet një të varfëri i cili ka nevojë. Allahu xh.sh. thotë: "Dhe jepni për në rrugë të Allahut e mos e hidhni veten në rrezik dhe bëni mirë, se me të vërtetë Allahu i do bëmërit".

Muslim QAzimi kl.IVa.

DISA TREGIME NGA HISTORIA ISLAME

1. DASHURIA E MUHAMEDIT A.S. NDAJ FËMIJËVE

Një ndër virtytet e Pejgamberit a.s. ka qenë edhe dashuria e tij ndaj fëmijëve. Ai shpeshherë argëtohej, luante dhe mahnitej me ta.

Tregohet se njëherë Pejgamberi a.s. ishte në sexhde. Shokët e tij vërejtën se ai në atë u ndal me tepër se sa rëndom. Kur u ngrit nga sexhdeja, shokët e pyetën: O i dërguar i Zotit, gjatë u ndale në sexhde dhe ne menduam se të ka ndodhur diçka. Ne menduam mos je duke e pranuar shpalljen. Muhamedi a.s. u përgjegj: "Nuk jam duke pranuar shpalljen, por djaloshi më pat hipur në shpinë dhe nuk dëshiroja ta pengojë në lojën e tij". Mendoj për nipat e tij Hasanin dhe Husejin.

Pejgamberi a.s. fëmijët e xhaxhait të tij Abasit i rreshtonte në një rend duke iu thënë: cili prej juve do të ngasë i pari tek unë do ta shpërblejë me këtë e këtë. Atëherë fëmijët rreshtoheshin dhe bënin gara ndërmjet veti se kush do të arrijë i pari te Muhamedi a.s., e kur lodheshin, uleshin te Pejgamberi a.s. duke u dëfryer në qetësi dhe lunturi. Me të vërtetë Pejgamberi a.s. ishte i mëshirshëm ndaj fëmijëve dhe me këtë mbetet shembull për të gjithë prindërit.

2. BISEDA E EBU HAJTHEMIT ME PEJGAMBERIN A.S.

Transmetohet se Ebu Hajthemu kishte shkuar një ditë te Pejgamberi a.s. dhe i tha:

"Nuk pata fat të marrë pjesë në Luftën e Bedrit edhe pse këtë e dëshiroja me të madhe, ashtu që me djalim tim hodhëm short e shorti i ra atij, që të marrë pjesë në këtë betejë e ai ra dëshmor. Në mbremje atë e pashë në ëndërr duke shëtitur nëpër kopshtet dhe lumenjtë e xhennetit dhe mua më tha: "Eja te ne të na shoqërosh në xhennet, atë që ma premtoi Allahu e gjeta, ajo është e vërtetë". Unë me padurim pres që

të bashkohem me të, jam plakur dhe eshtrat më janë ligshtuar, dëshiroj takim me Allahun, lutju Allahut o i dërguar i Tij, të ma mundësojë për të rënë shelih dhe ta shoqërojë djalim tim në xhennet! Muhamedi a.s. iu lut Allahut dhe ai ra shelih (dëshmor) në luftën e Uhudit.

3. GARAT NË MES TË BIRIT DHE BABAIT

Transmetohet se në disa luftëra babai dhe i biri bënin gara në mes veti se kush do të dalë në luftë, hidhnin short në mes veti, shorti i bie djalit e babai për këtë i thotë të birit: "Ma jep këtë herë mua radhën sepse unë jam babai yt!" Djali i thotë babait të tij: "Ky është xhenneti, e të ishte në pyetje diçka tjetër vallahi do ta kisha dhënë!!!

4. KËSHILLA E HASANIT DHE HUSEJNIT DHËNË NJERIUT I CILI MERRTE ABDEST

Hasani dhe Husejni një ditë e panë një njeri i cili merrte abdest dhe kuptuan se ai nuk merrte abdest mirë ashtu si duhet. Atëherë ata dy filluan të mendojnë se si t'i tregojnë atij që të marrë mirë abdest, e ai njeri të mos ofendohet. Iu afruan dhe i thanë atij që ai të gjykojë se cili nga këta të dy do marrë më mirë abdest. Njeriu pajtoi me këtë, dhe derisa ata merrnin abdest ai i shikonte. Dhe kështu, ai e pa se ku kishte gabuar kur ishte duke marrë abdest.

Ja, në këtë mënyrë Hasani dhe Husejni - nipat e Muhamedit a.s. ia mësuam njeriut drejtpraktikimin e marrjes së abdestit dhe i dhanë të kuptojnë se ku kishte gabuar.

Adnan Pallça kl. IIIa.

SHKËNDIJEZA ISLAME

PLOTËSIMI I IMANIT (BESIMIT)

Muhammed b. Ka'b ka thënë: Tri gjëra nëse i ka njeriu, ai ka plotësuar imanin në Zotin e Lartmadhëruar:

Nëse dëshiron diç, kurse një dëshirë e tillë nuk e fut në punë të keqe, nëse hidhërohet, hidhërimi i tillë nuk e largon nga e vërteta dhe nëse ka mundësi për të bërë diç, ai nuk e merr atë që nuk i takon.

KJO BOTË DHE BOTA TJETËR

(Dynjaja dhe Ahireti)

Omer b. Abdul-Azizi i shkroi El-Hasan El-Basriut dhe kërkoi prej tij që t'ia bashkojë çështjen e kësaj bote (dynjas) dhe botës tjetër (ahiretit) në një shkresë. Ai iu përgjigj:

Kjo botë nuk është gjë tjetër përveçse një ëndërr, kurse bota tjetër është një zhgëndërr, e vdekja është një gjë e ndërmjeme... Ne jemi në një konfuzion ëndrrash. Kush bën llogarinë e veprave të veta ai ka fituar, kurse kush është i pakujdesshëm ndaj tyre, ai ka humbur. Kush mendon pasojat, ai ka shpëtuar, ndërsa ai i cili i nënshtrohet epshit, ai ka tretur. Kush bën urtësi, ai ka fituar pasuri, kurse ai i cili ka dro Allahun ka shpëtuar. Kush ka konsideratë, është largpamës, e ai i cili është largpamës, ai edhe kupton, kurse ai që kupton edhe di, e ai që di, punon.

Nëse rrëshqet (bën gabim), tërhiq, e nëse pendohesh, tërhiq denjësisht, kurse nëse nuk di, atëherë pyet dhe kur të zemërohesh përmbahu.

EN-NU'MANU PRET BETEJEN

Në Nehavend, En-Nu'man el-Mezini ka thënë, para se të nisët lufta:

O Zoti im, lartësoje fenë Tënde, ndihmoj adhuruesit Tu dhe bëne en-Nu'manin të parin dëshmor sot...

O zoti im, të lutem që ta mbyllësh syrin tim sot me një çlirim në të cilin është lartësimi i Islamit. Besoni, Zoti mëshiron!

MARGARITARI DHE GUACA

Omer b. Abdul Azizit ia dërgoi bija c tij një margaritar dhe i tha atij: nëse gjen ndonjë margaritar të ngjashëm që t'i ngjes në veshët e mi! Atëherë ia dërgoi asaj dy guaca dhe i tha: Nëse mund t'i vendosësh këto dy guaca në veshët tu, do ta dërgoj një margaritar të ngjashëm.

LUMTURIA

Një burrë u zemërua në gruan e vet i tha asaj duke iu kërcnuar: Do të të bëjë të mjerë. Gruaja ia ktheu qetazi: Nuk mund të më bësh të mjerë. Burri tha përse! Ajo iu përgjigj: sikur t'ishite lumturia në pasuri, ti do t'ma ndalosh atë, ose po t'ishite në stoli, do t'ma pengoshe prej tyre. Megjithatë, lumturia është në diç tjetër që nuk e posedon ti e as mbar njerëzia. Vërtet, lutmurinë unë e gjej në imanin (besimin) tim, besimi im është në zemrën time, kurse mbi zemrën time s'ka pushtet askush përveç Zotit tim.

PËRGJIGJEJA ËSHTË SE ÇDO TË SHIQOSHE JO Ç'DËGJON!

Mbreti Bizantin i shkroi El-Mu'tesimit një shkresë me anën e të cilës i kërcnohej. Mu'tesimi urdhëroi që t'i përgjigjej atij. Mbasi që iu lexua përgjigjeja, ajo nuk i pëlqeu e i tha shkruarit (qatipit) shkruaj: bismil-lkahir-rrahmanir-rrahim, pastaj: E kam lexuar shkresën tuaj, kurse përgjigjeja është ajo se çka do të shiqosh e jo ç'dëgjon si dhe do të dinë pabesimtarët se kujt i takon përfundimi i tmerrshëm!

SI E KE FAMILJEN DHE SI I KE FËMIJET?

Ebu Bekër El-Bakilaniu ka qenë dijetar i shquar, mendjehollë dhe përkujtues i shpejtë. E kishte dërguar kryeministri i shtetit te mbreti bizantin në një mision të cilin e kishte kryer ashtu siç ishte më së miri. Në këtë udhëtim të tij ai takoi mitropolitin (kryepeshkopin) bizantin dhe deshi që të tallet me të. Në përsëritje e sipër El-Bakilaniu i tha:

Si je, si e ke familjen dhe fëmijët?

Mitropolit i zemëruar i tha atij me hidhërim:

Ka menduar ai i cili të ka dërguar ty se je mendjehollë dhe i mençur, a nuk e ke ditur se mitropolitët nuk kanë familje e as fëmijë?

El-Bakilaniu ia ktheu: Ju kemi parë juve se i mveshni All-llahut familje dhe fëmijë, e a janë priftërinjtë te ju më të shenjtë dhe me të lartë se sa All-llahu i Lartmadhëruar?!

QENI DHE DRERI

Thuhet, ka vrapuar qeni mbas një dreri, atëherë i tha dreri: Vërtet, ti kurrë nuk do të më arrish.

Qeni e pyeti, përse?

Dreri iu përgjigj: Sepse unë vrapojë për vetveten, kurse ti vrapon për pronarin tënd.

JETA FAMILJARE

Aktorja amerikane Barbara S., në një artikull gazetaresk ka shkruar:

Tek tani kam filluar që të bindem se gjëra të shumta më mungojnë: Jam interesuar më tepër se që duhet për jetën time artistike, kurse kam harruar jetën time si grua, si njeri, gjë që më ka bërë mua sot t'i xhelozojë femrat të cilat kanë kohë të njaftueshme për kujdesje ndaj burrave dhe fëmijëve të tyre. E vërteta është se suksesi dhe fama nuk kanë domethënie në mungesë të jetës familjare të zakonshme, atëherë kur femra e ndien veten grua.

Shqipëroi:

F. Hasani

RUBRIKA: PËR MË TË VEGJËLIT

KUPTIMI I ZEKATIT

Zekati, do të thotë lëmoshë (sadakë)

Zekati në kuptimin gjuhësor do të thotë: *pastërti*. Lëmoshë e detyrueshme Allahu xh.sh. e ka quajtur zekat dhe e ka përmendur në shumë vende në Kur'an si: "Merre zekatin nga pasuria e tyre që t'i pastroshe me të dhe t'i bësh të bekuar..." etj. Zekati është njëra prej pesë shtyllave të Islamit. Zekati, gjithashtu, përmendet edhe në shumë hadithe të Pejgamberit a.s. prej të cilëve kësaj radhe veçojmë: "Sigurone kapitalin tuaj me zekat".

Që lexuesit (e vegjel) sa ma mirë ta kuptojnë domethënien e zekatit, më poshtë po shënojmë një tregim kur'anor:

Personazhet:

1. *disa të varfër*

2. *Haxhi Muhamedi* - njeri i pasur që kishte një kopsht të begatshëm, nga i cili u jepte (shpërndante) të varfërve dhe të nevojtarëve.

3. *Ahmedi dhe Ibrahim* - bijtë e Haxhi Muhamedit, të cilëve kur u vdiq i ati ndërpreu dhënien e zekatit (lëmoshës) të varfërve.

PAMJA I

Të varfërit: Es-salamu alejke, o babai i Ahmedit! (disa të tjerë): Es-salamu alejke, o Haxhi Muhamed!

Haxhi Muhamedi: Ve alejkums-salam! Mirë se erdhet në kopshtin tim!

Të varfërit: A do të na japësh nga ajo që të ka dhënë Allahu nga frutat e kopshtit, ashtu siç na jepshë çdo vit?

Haxhi Muhamedi: sigurisht, ajo është e drejtë e juaja, një e dhjeta e fruteve të kopshtit tim gjithmonë janë tuajat.

Të varfërit: (të gjithë njerëzit): Allahu të shpërbleftë pa masë, dhe ta shtoftë bereqetin!

PAMJA II

I varfëri i parë: Es-salamu alejke, o Ahmed!

I varfëri i dytë: Çdo vit më të mira e bereqet! A do të na japësh prej frutave të kopshtit ashtu siç na jepte yt at, Allahu të mëshiroftë?

Ahmedi: Për këtë çështje së pari më duhet të bisedoj me tim vëlla.

PAMJA III

Ahmedi: Ç' mendojnë Ibrahim, a do t'u japim (shpërndajmë) këtë vit të varfërve prej frutave të kopshtit, siç vepronte çdo vit babai ynë?

Ibrahim: Jo, jo, nuk u japim asgjë!

Ahmedi: Por, ajo është e drejtë e tyre në zekat, dhe babai ynë gjithmonë u ka dhënë, andaj...

Ibrahim: Asgjë nuk do të marrin dhe pikë. Ne kemi të drejtë në kopshtin tonë e jo ata. Kopshti është i yni e jo i tyre, dhe për këtë as që dua të dëgjoj më.

Ahmedi: Mirëpo ata do të vijnë kur t'i vjelim frutat.

Ibrahim: në kopsht do të shkojmë fshehtas (pa u hetuar), dhe asnjë prej të varfërve nuk do të na vërejë!

PAMJA IV

Ahmedi: O zoti im, ç' paska ndodhur kështu me kopshtin tonë?! Kopshti nuk paska frutal

Ibrahim: O mjerimi ynë, ç'është kjo... ku kanë... ku kanë... shkuar frutat, ku janë?!?

Ahmedi: Prej qiellit ka zbritur shkatërrimi dhe ka shkatërruar frutat.

Ibrahim: Qenka bërë si i djegur, hi e pluhur, o mjerimi ynë!

Ahmedi: Ah sikur mos t'ua ndalonim të varfërve pjesën e tyre! Ah! sikur t'ua jepnim hakun e tyre siç bënte babai ynë...! Of! mjerë për mua, pse e dëgjova Ibrahimin. Allahu xh.sh. është hidhëruar në ne. Ne i bëmë të padrejtë vetës tonë dhe e merituam... E, a nuk ka thënë Allahu xh.sh.: "Ata që bëjnë koprraci me atë çka u ka dhënë Allahu nga pasuritë e veta, kursesi mos të mendojnë se ajo është e mirë për ata, jo, ajo është e keqe për ata. Në ditën e kijametit do t'u varen në qafë ajo, që e kanë kursyer..." (Ali Imran, 180) Kurse Pejgamberi a.s. ka thënë: "Siguroni kapitalin tuaj me zekat". (më gjëresisht për këtë shih kapitlen "El-Kalem" ajeti 17-33).

Osman MEHMETI kl. IV.

LETRATE LEXUESVE

Edhe kësaj radhe në redaksinë tonë kanë arritur një mori letrash me përshëndetje e sygjërime. Këto letra kanë arritur nga anë të ndryshme të territorit të Kosovës, që dëshmon për interesimin që kanë ndaj fletushkës sonë. Kësaj radhe veçuem këto:

Ardian Kadrijaj dhe Imer Mushkolaj nga Deçani - nxënës të KL IV gjimnazi N. F. na përshëndesin në punën dhe aktivitetet tona dhe njëherit ata kërkojnë që të jemi më të zëshëm në shkrimet tona, gjegjësisht që fletushka jonë të jetë më e pasur me shkrime që u dedikohen ekskluzivisht rinisë.

I falënderojmë këta nxënës për përshëndetjet dhe sygjërimin që na e dërguan dhe u urojmë suksese në mësim.

Gjithashtu na përshëndesin edhe Bekim Bunjaku nga Gjilani si dhe Mensur Berisha fsh. Majac KK Podujevë. Ky i fundit na ka dërguar edhe një vjershë të cilën besojmë se do ta botojmë në njërin prej numrave të ardhshëm.

I falënderojmë për letrat dhe përshëndetjet e tyre, dhe kërkojmë edhe më tutje bashkëpunim, ngase ky bashkëpunim shkon në interes të dyanshëm.

REDAKSION

Letërsia

SATIRË - HUMOR - ARGËTIM

A E DINI SE...

...Rreth vitit 1700 në Angli ishte përhapur besimi se të ngulësh gozhdë në lis pushon dhembja e dhëmbit.

...Mjeku musliman Err-Rrazi në Evropë i njohur si RAZES, shkroi më se 220 vepra medicinale, prej të cilave disa enciklopedi medicinale. Disa prej këtyre veprave janë përkthyer në gjuhën latine dhe janë studiuar shumë shekuj në katedrat medicinale evropiane.

...Mbreti francez Henriku III në vitin 1587 në Pariz themeloi katedrën për gjuhë arabe, që të lehtësonte përpunimin e studimeve medicinale.

...Ujëvarat e "Iguistit", të cilat gjenden në trekufirin tropikal; Argjentinë, Brazil, Peru janë karakteristike. Atje ndodhen 21 ujëvare që derdhen 140 milion tonë ujë në thellësi prej 70-80m. (7 herë më shumë se ato të Niagarës). Zhurma dhe ushtrimi e derdhjes së ujit dëgjohet deri 25 km. largësi.

...Ibën Sina në moshën 9 vjeçare është bërë hafiz, ndërsa në moshën 17 vjeçare është bërë mjek.

...Mendimtari i madh islam Gazaliu (1058-1111) për 53 vjetët e jetës së tij shkroi mbi 700 vepra në lëmi të ndryshme të shkencës islame.

...Udhëheqësi i ushtrisë muslimane Halid ibn Velidi asnjëherë nuk përjetoi humbje. Derisa ishte idhujtar, në Uhud-625, e mundi edhe ushtrinë muslimane.

...Sot në botë ekzistojnë mbi 90 banka të cilat veprojnë sipas ligjit të Allahut (shariatit), - pa kamatë.

...Mu në qendër të Granadës (Spanjë) një papagall bëri tollovi duke ndaluar trafikun disa orë. Pronari i këtij papagalli e kishte ushtruar që të imitojë pipin e policit të trafikut dhe papagalli duke qëndruar në ballkonin fishkëllontë dhe i habiste vozitësit. Kundëstarët e trafikut vetëm pas disa orëve mezi e rregulluan trafikun.

...Tarantulla quhet marimanga më helmuese e cila është lloj i vetëm në familjen e marimangave e cila nuk posedon aftësi për thurjen e rrjetit.

IRFAN KRASNIQI KL. IIB

POLITIKA

E rëndë si tanksa,
e mprehtë si thika,
gjithmonë ka qenë
POLITIKA.

Kur në kuvend
njëri diskuton,
syri shikon eq,
kritika pason.

Njëri kështu e tjetri
ashtu,
mbledhja merr fund,
zgjidhja askund!!!

BESNIK BERISHA

NE PYESIM JU PËRGJIGJUNI

Lexues të nderuar Rubrika jonë ka nxitur kureshtjen tuaj të pajisni me më shumë njohuri për gjëra fetare dhe për fletushkën tonë.

Si çdoherë edhe kësaj radhe në redaksinë tonë arriti një numër i konsiderueshëm i letrave tuaja me përgjigje të sakta në pyetjet e parashtruara në numri i kaluar.

Si çdo lojë shpërblyese edhe loja jonë ka fituesit e saj, të cilët në mënyrë korrekte u përgjigjen në pyetjet tona. Kësaj radhe patën fatin këta garues: Ramadan Haliti fsh. Rekë KK Mitrovicë, Ilir Krasniqi KK Junik dhe Baki Malsiu KK Kaqanik.

Të gjithë atyre të cilët nuk patën fat kësaj radhe iu dëshirojmë sukses dhe pjesëmarrje në të ardhmen.

Përgjigjet e pyetjeve në numrin e kaluar janë:

1. Kushtet e fesë islame janë 33, dhe ndahen në 6 të imanit 5 të islamit, 12 të namazit të abdestit, 3 të guslit, dhe 3 të tejmumit.

2. Librat e mëdha të shpallura janë 4: Tevrat - Musaut a.s., Zeburi - Davudit a.s., Inxhilit - Isaut a.s. dhe Kur'ani - Muhamedit a.s..

3. Muslimanët e pasur e kanë obligim që prej pasurisë së tyre të japin zekatin.

4. Akti i parë për sovranitetin e Kosovës u mbajt me 2 korrik 1990 para ndërtesës së kuvendit në Prishtinë.

Ndërsa pyetjet e reja për këtë numër janë:

1. Cilët ishin 4 halifët (prijësit) e parë të muslimanëve pas Muhamedit a.s.?

2. Në cilën shpellë iu shpall ajeti i parë të Dërguarit a.s.?

3. Kush e forumloi kalendarin e muslimanëve dhe në çka u bazua?

4. Kur dhe ku u mbajt simpoziumi ndërkombëtar me temën "Feja, tradita dhe kultura islame ndër shqiptarët"?

Mbetemi me shpresë se do të përgjigjeni lehtë në pyetjet tona. Nëse keni vështirësi apo paqartësi kërkoni ndihmën prej prijësit fetar.

Ju ftojme në bashkëpunim të mëtutjeshëm me fletushkën tonë.

REDAKSIA

FJALËKRYQI MAGJIK

I	L	I	R
L	I	R	I
I	R	A	N
R	I	N	I

1. Paraardhsi yni.

2. Ideal elementar i një populli (i pa shquar/i pa shq./.)

3. Shtet shi-it (i pa shquar.).

4. Gjenerata rinore (i pa shq.).

BESNIK BERISHA